

VËLLIMI XIX / PRILL – QERSHOR / 2022

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

BULETINI ZYRTAR

PËRMBAJTJA

Nr. 875, Datë 08.04.2022.....	4
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË MOONEY GROUP S.P.A. NGA SHOQËRITË BANKA 5 S.P.A. DHE ENEL X S.R.L.”	
Nr. 876, Datë 08.04.2022.....	8
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË 50% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË LOTOS-AIR BP POLSKA SP.Z.O.O NGA SHOQËRIA ARAMCO OVERSEAS COMPANY B.V.”	
Nr. 877, Datë 08.04.2022.....	11
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË LG ELECTRONICS INC. DHE SM ENTERTAINMENT CO., LTD.”	
Nr. 878, Datë 15.04.2022.....	14
“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES AGRO BLEND SHPK PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 874, DATË 25.03.2022 TË KOMISIONIT TË KONKURENCËS”	
Nr. 879, Datë 15.04.2022.....	16
“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES ÇAÇA SHPK PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 874, DATË 25.03.2022 TË KOMISIONIT TË KONKURENCËS”	
Nr. 880, Datë 15.04.2022.....	18
“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES MBM SHPK PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 874, DATË 25.03.2022 TË KOMISIONIT TË KONKURENCËS”	
Nr. 881, Datë 22.04.2022.....	20
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË LANCO MANDAKANI HYDRO ENERGY PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS.”	
Nr. 882, Datë 22.04.2022.....	23
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FAZUA GMBH NGA SHOQËRIA PORSCHE INVESTMENTS GMBH”	
Nr. 883, Datë 18.05.2022.....	26
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË DISA ASETEVE TË SHOQËRIVE TË CAKTUARA TË GRUPIT AUTO-HOLDING DRESDEN NGA SHOQËRIA VGRDD GMBH”	

Nr. 884, Datë 18.05.2022.....	29
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJES NOA CONTROL SHPK NË TREGUN E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT LIGJOR TË INSTRUMENTEVE MATËSE, NËPËRMJET VERIFIKIMIT TË INSTRUMENTEVE SHPËRNDARËSE TË KARBURANTIT DHE GAZIT TË LËNGSHËM, ME DETYRIME PËR NDËRMARRJEN NOA CONTROL SHPK DHE REKOMANDIME PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË”	
Nr. 885, Datë 27.05.2022.....	37
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË INTENTA GMBH NGA SHOQËRIA CARIAD SE”	
Nr. 886, Datë 27.05.2022.....	40
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË VUB GENERALI DOCHODKOVA SPRAVCOVSKA SPOLOCNOST’, A.S NGA SHOQËRIA VŠEOBENCNÁ ÚBEROVÁ BANKA, A.S”	
Nr. 887, Datë 10. 06 . 2022	44
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BANCA COMERCIALĀ “ENERGBANK” S.A. NGA SHOQËRIA AS IUTECREDIT EUROPE”	
Nr. 888, Datë 10.06.2022.....	46
“MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.779, DATË 04.03.2021 “MBI MONITORIMIN E VENDIMIT NR. 723, DATË 17.11.2020 “PËR MBYLLJEN, ME KUSHTE DHE DETYRIME, TË PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË SEKTORIN BANKAR PËR BANKËN RAIFFEISEN, BANKËN KOMBËTARE TREGTARE, BANKËN CREDINS DHE BANKËN INTESA SANPAOLO” PËR PERIU DHËN 2019-2020 DHE DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE”	
Nr. 889, Datë 10.06.2022.....	49
“MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 755, DATË 09.12.2020 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA) NGA SHOQËRIA KASTRATI GROUP SHA”	
Nr. 890, Datë 10.06.2022.....	53
“MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT MBI KUFIZIMET E KONKURRENCËS “SIPAS OBJEKTIT” PËR QËLLIME TË PËRCAKTIMIT TË MARRËVESHJEVE ME RËNDËSI TË VOGËL”	
Nr. 891, Datë 14.06.2022.....	55
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË AUTOZENTRUM SPORT	

AS NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE
AKTIENGESELLSCHAFT”

Nr. 892, Datë 14.06.2022..... 58

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT / JV NGA SHOQËRITË SLOVENSKÁ SPORITEL’ ŇA, A.S., VŠEOBECNÁ ÚVEROVÁ BANCA, A.S., TATRA BANKA, A.S., ČESKOSLOVENSKÁ OBCHODNÁ BANKA, A.S. DHE 365. BANK, A.S.”

Nr. 893, Datë 14.06.2022..... 62

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FORD ROMANIA SA NGA SHOQËRIA FORD OTOSAN NETHERLANDS B.V.”

Nr. 894 , Datë 24.06.2022..... 65

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES VODAFONE ALBANIA SHA NË TREGUN E SHËRBIMEVE CELULARE: TREGU ME SHUMICË I TERMINIMIT TË THIRRJEVE NDËRKOMBËTARE”

VENDIM

Nr. 875, Datë 08.04.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË MOONEY GROUP S.P.A. NGA SHOQËRITË BANKA 5 S.P.A. DHE ENEL X S.R.L.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëritë Banka 5 S.p.A. dhe Enel X S.r.l.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëritë Banka 5 S.p.A. dhe Enel X S.r.l.

VËREN SE :

I. Palët në transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përfthimit të kontrollit të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëritë Banka 5 S.p.A. dhe Enel X S.r.l.

Referuar “Marrëveshje shitje dhe transferimi aksionesh në lidhje me Mooney Group S.p.A.”, dhe “Marrëveshjes Kuadër”, të nënshkuara më datë 23 dhjetor 2021, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse:

Blerësi 1: Banka 5 S.p.A. është një shoqëri aksionare e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve bankare, si dhe shërbime grumbullimi dhe pagese për shitësit monopol, si p.sh. tregtarët e duhanit etj. Banka 5 S.p.A. zotëron 30% të kapitalit të shoqërisë Mooney Group S.p.A.

Banka 5 S.p.A. i përket grupit të shoqërive të drejtuara nga Intesa Sanpaolo S.p.A, e cila është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania ShA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar me objekt aktiviteti: veprimtari bankare, veprimtari financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licencuar nga AMF dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.

Blerësi 2: Enel X S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë me objekt aktiviteti fokusimin në zhvillimin e produkteve inovative dhe zgjidhjeve dixhitale në fushat ku energjia tregon potencialin më të madh të transformimit, p.sh., qytetet inteligjente dhe lëvizshmëria elektronike. I gjithë kapitali aksionar i shoqërisë Enel X S.r.l. zotërohet nga shoqëria Enel S.p.A. Enel S.p.A. është shoqëria mëmë e Grupit Enel, i cili është aktiv në mbarë botën në sektorin e energjisë dhe gazit natyror.

[...]

Pala Shitëse: Schumann Investments S.A është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Shoqëria Schuman Investments S.A zotëron plotësisht kapitalin aksionar të shoqërisë SG2 S.p.A, e cila është zotëruese e 70% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, Mooney Group S.p.A.

Target: Mooney Group S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar në bazë të ligjeve të Italisë me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimeve nëpërmjet një rrjeti pikash shitjeje të ndërlidhura në Itali (p.sh., shitës duhani, bare dhe standat e gazetave) dhe nëpërmjet platformave dixhitale. Mooney Group S.p.A. gjithashtu ofron shërbime të biletave dixhitale të transportit në Itali përmes platformës MyCicero.

Mooney Group S.p.A. nuk ka filiale, aktivitete dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 23 Dhjetor 2021, shoqëritë Schuman Investmen S.A, Enel X S.r.l. dhe Banka 5 S.p.A., kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje shitje dhe transferimi aksionesh në lidhje me Mooney Group S.p.A.” dhe në të njëjtën datë shoqëritë Enel X S.r.l., Banka 5 S.p.A., Enel S.p.A. dhe Intesa Sanpaolo S.p.A. kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje Kuadër”.

Referuar “Marrëveshjes së shitjes dhe transferimit të aksioneve në lidhje me Mooney Group S.p.A.”, Schuman Investmen S.A do t’i shesë dhe transferojë tek shoqëria Enel X S.r.l. 50% të kapitalit të shoqërisë Mooney Group S.p.A. Gjithashtu Schuman Investments S.A do t’i shesë dhe transferojë tek Banka 5 S.p.A. 20% të aksioneve të shoqërisë Mooney Group S.p.A.

Pas përfundimit të transaksionit të parë, kapitali aksionar i shoqërisë target Mooney Group S.p.A. do të kontrollohet bashkërisht nga shoqëritë Enel X S.r.l. në masën 50% dhe nga Banka 5 S.p.A. në masën 50%.

Referuar “Marrëveshjes Kuadër”, palët synojnë të rregullojnë detyrimet dhe angazhimet e tyre përkatëse, si dhe të rregullojnë disa aktivitete përgatitore dhe funksionale për zbatimin e transaksionit të përgjithshëm Mooney (transaksioni i parë dhe i dytë).

Bazuar në këtë marrëveshje, pas përfundimit të transaksionit të parë, do ta mbahet një takim i Bordit të Drejtorëve të Mooney Group S.p.A. për të vendosur për miratimin dhe nënshkrimin nga Enel X (si shitës) dhe Mooney Group S.p.A. (si blerës) të Marrëveshjes së Blerjes së aksioneve, në lidhje me blerjen nga Mooney

Group S.p.A., të investimeve në kompanitë e synuara (transaksioni i dytë) dhe në përfundim të këtij transaksioni Mooney Group S.p.A. do të zotërojë 100% të kapitalit aksionar të shoqërive të mëposhtme: Enel X Financial Services S.r.l.; CityPoste Payment S.p.A.; Junia Insurance S.r.l. dhe PayTipper S.p.A..

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.5.2 “Transaksionet e ndërvarura”, parashikohet se dy ose më shumë transaksione përbëjnë një përqendrim të vetëm, nëse ato janë unike në natyrë. Me qëllim që të përcaktohet natyra unike e transaksionit, është e nevojshme që këto transaksione të jenë të ndërvarura, në mënyrë të tillë që një transaksion nuk do të ishte kryer pa tjetrin. Transaksioni i propozuar, i përgjithshëm, (transaksioni i parë dhe transaksioni i dytë), cilësohet si një transaksioni unitar, pasi këto transaksione janë të lidhura me njëra-tjetrën ligjërisht, janë të ndërvarura dhe janë të kryera nga palë të njëjta, Grupi Intesa Sanpaolo dhe Grupi Enel. Gjithashtu transaksioni i dytë nuk do të zbatohet derisa të përfundojë transaksioni i parë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëritë Banka 5 S.p.A. dhe Enel X S.r.l., i parashikuar në nenin 10 dhe referuar pasqyrave financiare të palëve, plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 12 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimit të pagesave nëpërmjet rrjetit të pikave të shitjes, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëria Banca 5 S.p.A. dhe shoqëria Enel X S.r.l., i klasifikuar si një përqendrim konglomerat.

Banca 5 S.p.A. është një nga bankat italiane që i përket Grupit Intesa Sanpaolo, i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Enel X S.r.l. është pjesë e grupit Enel i cili kryesohet nga shoqëria mëmë përfundimtare Enel S.p.A. Grupi Enel nuk ka filiale, aktivitet dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Mooney Group S.p.A. është prezent ekskluzivisht në Itali dhe nuk ka filiale apo aktivitet në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Mooney Group S.p.A. nga shoqëria Banca 5 S.p.A. dhe shoqëria Enel X S.r.l
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 876, Datë 08.04.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË 50% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË LOTOS-AIR BP POLSKA SP.Z.O.O NGA SHOQËRIA ARAMCO OVERSEAS COMPANY B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 50% të aksioneve të shoqërisë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 50% të aksioneve të shoqërisë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Lotos- Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje paraprake për blerjen e aksioneve” të datës 11 Janar 2022, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Aramco Overseas Company B.V, (AOC) është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Hollandës me objekt aktiviteti: Dizenjim teknik dhe konsulencë inxhinierike e të tjera; shoqëri holding; shoqëri pjesëmarrëse.

AOC B.V, është një shoqëri e zotëruar tërësisht nga Saudi Arabian Oil Company, një shoqëri aksionare e themeluar nëpërmjet Dekretit Mbretëror të Arabisë Saudite. Saudi Arabian është një shoqëri kryesisht e angazhuar në kërkimin, eksplorimin, shpimin dhe nxjerrjen e substancave hidrokarbureve dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe tregtimin e këtyre substancave.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka ndonjë filial të regjistruar në Shqipëri, [...].

Pala shitëse: Grupa Lotos SA (Grupi Lotos) është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Polonisë, me objekt aktiviteti: Prodhim dhe përpunim produktesh nga rafineritë e naftës; transport me tubacion; prodhim i kimikateve të tjera bazë organike; magazinim dhe ruajtja e mallrave; shitje me shumicë e karburanteve dhe produkteve derivative etj.

Target: Lotos-Air BP Polska Spolka Z Ograniczona Odpowiedzialnoscia (Lotos-Air BP Polska) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Polonisë, me objekt aktiviteti: Shitje me shumicë karburanti dhe produkte derivate; veprimtari e agjentëve që merren me shitjen e karburanti, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale; magazinimi dhe ruajtja e mallrave të tjerë; veprimtari mbështetëse për transportin ajror etj.

Shoqëria Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o, aktualisht kontrollohet nga Grupa Lotos SA dhe nga BP Europa SE, ku secili zotëron 50% të aksioneve dhe kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o.

BP Europa SE është një shoqëri europiane, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, filial i zotëruar indirekt nga BP p.l.c me objekt aktiviteti: Nxjerrja, përpunimi, ruajtja, transportimi dhe shpërndarja e gazit, naftës, gazit natyror dhe mineraleve të tjera; prodhimi, përpunimi, magazinimi, transporti dhe shpërndarja e produkteve të parftuara nga nafta, gazi natyror ose minerale të tjera; prodhimi, përpunimi dhe shpërndarja/shitja e vajrave minerale dhe jominerale, i të gjitha llojeve të produkteve kimike, produkteve plastike për nevoja të automjeteve dhe mjeteve motorike si dhe furnizime për mjetet lundruese dhe avionë etj.

BP është një shoqëri e integruar energjitike që ushtron aktivitetin në Evropë, Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut, Australi, Azi dhe Afrikë, shoqëria mëmë e një grupi ndërkombëtar të njësive ekonomike të përqendruara në katër grupe biznesi: (i) prodhimi dhe vendosja në funksion e hidrokarbureve (naftë dhe gaz); (ii) klientët dhe produktet-e cila rrit lehtësitë dhe ofertat e lëvizshmërisë së BP për klientët; (iii) gaz dhe energji të ulët të karbonit; dhe (iv) inovacioni dhe inxhinieria për drejtimin e transformimit dixhital.

BP është prezente dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes filialit të saj Air-BP Albania SHA. (zotërohet 100% nga BP Holdings International B.V.)

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Grupa Lotos SA (shitësi), shoqërisë Aramco Overseas Company B.V (blerësi), është lidhur “Marrëveshje paraprake për blerjen e aksioneve”, në shoqërinë target Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o, datë 11 Janar 2022.

Referuar kësaj Marrëveshje, shoqëria Grupa Lotos SA është zotëruesi i vetëm mbi aksionet që përfaqësojnë 50% të të gjithë kapitalit aksionar të emtuar të shoqërisë.

Transaksioni i njoftuar, është pjesë e zbatimit të angazhimeve të përcaktuara nga Komisioni Evropian për rastin ORLEN¹ dhe pjesë integrale e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve mes Aramco Overseas Company B.V dhe Grupa LOTOS.

Në zbatim të angazhimeve, Grupa Lotos SA(shitësi) ka rënë dakord të shesë dhe Aramco Overseas Company B.V (blerësi), ka rënë dakord të blejë Aksionet në zbatim të Kushteve Paraprake të përcaktuara në “Marrëveshjen paraprake për blerjen e aksioneve”.

¹ Më 3 korrik 2019, Komisioni Evropian ka marrë njoftimin e shoqërisë Orlen për përfundimin e kontrollit të shoqërisë LOTOS, nëpërmjet blerjes së 32.99% të aksioneve të LOTOS, përqendrim i njoftuar në zbatim të nenit 4 të Rregullores së Këshillit 139/2004/KE "Mbi Kontrollin e Përqendrimeve të Ndërmarrjeve". Më 23 qershor 2020, Orlen dhe Grupa Lotos SA ndërmorën angazhime përballë Komisionit Evropian dhe në 14 korrik 2020, Komisioni Evropian nxori Vendimin e tij (çështja M.9014). në të cilin i konsideronte angazhimet si pjesë përbërëse dhe të pandarë të Vendimit.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e 50% të aksioneve në shoqërinë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V. dhe pas transaksionit shoqëria Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o do të kontrollohet bashkërisht nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V dhe BP Europa SE.

Referuar marrëveshjeve si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes së karburanteve dhe produkteve derivate të tij, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit, nëpërmjet blerjes së 50% të aksioneve të shoqërisë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

Aramco Overseas Company B.V, zotërohet tërësisht nga Saudi Arabian Oil Company, e cila nuk ka ndonjë filial të regjistruar në Shqipëri, [...].

Shoqëria Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o, aktualisht kontrollohet nga Grupa Lotos SA dhe nga BP Europa SE, secili zotëron 50% të aksioneve dhe kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o.

Lotos-Air BP Polska nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

BP Europa SE është një filial indirekt i BP p.l.c, pjesë e grupit BP, e cila është prezente dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes filialit të saj Air-BP Albania SHA.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 50% të aksioneve të shoqërisë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 877, Datë 08.04.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË LG ELECTRONICS INC. DHE SM ENTERTAINMENT CO., LTD.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë LG Electronics Inc. dhe SM Entertainment Co., Ltd.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë LG Electronics Inc. dhe SM Entertainment Co., Ltd.

VËREN SE :

I. Palët në transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, shoqërinë Fitness Candy Co., Ltd., nga shoqëritë LG Electronics Inc. dhe SM Entertainment Co., Ltd.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët” ndërmjet shoqërive LG Electronics Inc. dhe SM Entertainment Co., Ltd., nënshkruar më datë 30 dhjetor 2021, palët janë:

Pala 1: LG Electronics Inc. është një shoqëri koreane, e inkuorporuar sipas legjislacionit të Republikës së Koresë, një prodhues dhe furnizues ndërkombëtar i pajisjeve elektronike, pajisjeve të komunikimit celular dhe pajisjeve shtëpiake. LG Electronics Inc. e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet katër njësisive biznesi: (i) Argëtim në shtëpi; (ii) Zgjidhje për biznesin; (iii) Pajisje shtëpiake dhe ajrimi; (iiii) Komponentë për automjete.

Pala 2: SM Entertainment Co., Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Koresë, e cila ushtron aktivitetin në industrinë koreane të argëtimit

SM Entertainment Co., Ltd. nuk është e pranishme në tregun shqiptar, megjithatë ka realizuar të ardhura në një vlerë të papërfillshme për vitin 2020.

Fitness Candy CO., Ltd., (JVC), do të themelohet si një shoqëri aksionare sipas legjislacionit të Republikës së Koresë. Aktivitetet tregtare që synon të ushtrojë ndërmarrja e përbashkët do të përfshijnë: (i) Funksionimin e një platforme që ofron përmbajtje; (ii) Shërbime dhe produkte të lidhura me fitnesin; (iii) Planifikimi dhe krijimi i përmbajtjeve të lidhura me fitnesin; (iiii) Funksionimi i një studioje të lidhur me fitnesin dhe operacioni i biznesit i rastësishëm ose i lidhur me secilën më sipër.

I. Transaksioni

Më datë 30 Dhjetor 2021 është nënshkruar “Marrëveshje për sipërmarrjen e përbashkët” ndërmjet shoqërive LG Electronics Inc. dhe SM Entertainment Co., Ltd. Referuar kësaj Marrëveshje, si fillim [_____].

Menjëherë pas mbylljes së fazave të nënshkruara më sipër dhe pas implementimit të transaksionit, shoqëria [_____].

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një shoqërie të përbashkët (joint venture), me funksione të plota, nga shoqëritë LG Electronics Inc. dhe SM Entertainment Co., Ltd., duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për aplikacionet e shëndetit dhe fitnesit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, Fitness Candy CO., Ltd., nga shoqëria LG Electronics Inc. dhe shoqëria SM Entertainment Co., Ltd.

SM Entertainment Co., Ltd. nuk është e pranishme në tregun shqiptar, megjithatë ka realizuar të ardhura në një vlerë të papërfillshme për vitin 2020.

Fitness Candy CO., Ltd., do të jetë aktive vetëm në Republikën e Koresë së Jugut.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë LG Electronics Inc. dhe shoqëria SM Entertainment Co., Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 878, Datë 15.04.2022

**“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES AGRO BLEND SHPK
PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 874, DATË 25.03.2022 TË KOMISIONIT
TË KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d), neni 26, neni 46 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003);

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, si dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Ndërmarrja AGRO BLEND SHPK me anë të shkresës së saj nr. 310 prot., datë 05.04.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 256 prot, dt. 06.04.2022), me lëndë “Ankim kundër Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874, datë 25.03.2022”, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022, pasi kjo ndërmarrje bazuar në KPrA, si dhe nenin 46, pika c), të Ligjit nr. 9121/2003, gjykon se ky vendim është marrë mbi të dhëna jo të plota dhe aspak të sakta, duke paraqitur dhe argumentet mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj.
2. Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK dhe argumentet e paraqitura prej saj, argumente këto të cilat janë parashtruar me shkrim nga ana e kësaj ndërmarrjeje pas seancës dëgjimore të zhvilluar me Komisionin e Konkurrencës më datë 17.03.2022, para marrjes së vendimit përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 objekt ankimi, duke mos paraqitur fakte dhe të dhëna shtesë lidhur me këtë vendimarrje.
3. Bazuar në nenin 32 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
4. Në respektim të Ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, procedura administrative e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure ka

përfunduar me marrjen e vendimit administrativ përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, vendim i cili, në respektim të nenit 79 të ligjit nr. 9121/2003, mund të ankimohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

5. Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.
6. Në respektim të këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - a) Njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
 - b) Palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - c) Vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
7. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), dhe nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.
- II. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 879, Datë 15.04.2022

**“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES ÇAÇA SHPK PËR
REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 874, DATË 25.03.2022 TË KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26, neni 46 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003);

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për anulimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, si dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

8. Ndërmarrja ÇAÇA SHPK me anë të shkresës së saj të datës 04.04.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 204/1 prot, dt. 06.04.2022), me lëndë “Kundërshtim i vendimit nr. 874, datë 25.03.2022”, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës anulimin e vendimit nr. 874, datë 25.03.2022, për gjobën në shumën prej 7,087,994 lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c) të Ligjit nr. 9121/2003, duke paraqitur dhe argumentet mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj.
9. Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes ÇAÇA SHPK dhe argumentet e paraqitura prej saj, argumente këto të cilat janë parashtruar nga ana e kësaj ndërmarrjeje edhe para marrjes së vendimit përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 objekt ankimi, duke mos paraqitur fakte dhe të dhëna shtesë lidhur me këtë vendimarrje.
10. Bazuar në nenin 32 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
11. Në respektim të Ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, procedura administrative e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure ka përfunduar me marrjen e vendimit administrativ përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të

Konkurrencës, vendim i cili, në respektim të nenit 79 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të ankimohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

12. Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.
13. Në respektim të këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - d) Njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
 - e) Palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - f) Vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
14. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes ÇAÇA SHPK nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), dhe nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.
- II. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes ÇAÇA SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 880, Datë 15.04.2022

**“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES MBM SHPK PËR
REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 874, DATË 25.03.2022 TË KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes MBM SHPK për revokimin/pezullimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d), neni 26, neni 46 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003);

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes MBM SHPK për revokimin/pezullimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, si dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

15. Ndërmarrja MBM SHPK me anë të shkresës së saj nr. 125 prot., datë 31.03.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 169/9 prot, dt. 04.04.2022), me lëndë “Ankim administrativ ndaj Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874, datë 25.03.2022”, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës revokimin/pezullimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022, pasi kjo ndërmarrje, bazuar në K.Pr.A, si dhe nenin 46 të Ligjit nr. 9121/2003, gjykon se ky vendim është marrë mbi të dhëna jo të plota dhe aspak të sakta, duke paraqitur dhe argumentet mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj.

16. Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes MBM SHPK dhe argumentet e paraqitura prej saj, argumente këto të cilat janë parashtruar me shkrim nga ana e kësaj ndërmarrjeje pas seancës dëgjimore të zhvilluar me Komisionin e Konkurrencës më datë 23.03.2022, para marrjes së vendimit përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022, objekt ankimi, duke mos paraqitur fakte dhe të dhëna shtesë lidhur me vendimarrjen.

17. Sa i përket pretendimit të ndërmarrjes MBM SHPK për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të përdorur në nxjerrjen e VKK nr. 874, datë 25.03.2022, sqarojmë se para marrjes së këtij vendimi përfundimtar, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të Ligjit nr. 9121/2003, i ka dhënë ndërmarrjes MBM SHPK të drejtën për t’u dëgjuar, duke i vënë në dispozicion raportin e hetimit të thelluar, të drejtë të cilën ndërmarrja MBM SHPK e ka ushtruar duke u paraqitur në seancën degjimore me Komisionin e Konkurrencës, si dhe duke paraqitur pretendime dhe parashtrime me shkrim lidhur me

çështjen, pa ushtruar të drejtën për t'u konsultuar me dosjen, si një e drejtë procedurale që gëzon pala gjatë një procedure administrative dhe që duhet të ushtrohet duke paraqitur një kërkesë të arsyetuar me shkrim gjatë procedurës, në respektim të nenit 45 të K.Pr.A-së, si dhe nenit 17 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, gjë e cila nuk ka ndodhur.

18. Në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, procedurat administrative të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure kanë përfunduar me marrjen e vendimit administrativ përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, vendim i cili, në respektim të nenit 79 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të ankimohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.
19. Bazuar në nenin 32 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
20. Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.
21. Në respektim të këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - g) Njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
 - h) Palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - i) Vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
22. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes MBM SHPK dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes MBM SHPK nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), dhe nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

I. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes MBM SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

II. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes MBM SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 881, Datë 22.04.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË LANCO MANDAKANI HYDRO ENERGY PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Referuar dokumentacionit të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe Planit të Zgjidhjes, datë 2 nëntor 2021, palët janë:

Pala blerëse: Statkraft IH Holdings AS, është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme.

Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë në Evropë. Shoqëria Statkraft AS është shoqëria mëmë e Statkraft Group, plotësisht në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: ...veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike..etj.

Devoll Hydropower SHA, është shoqëri aksionare, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MË në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shoqëria Target: Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited, është një shoqëri private e kufizuar në kuota, e themeluar sipas legjisllacionit të Indisë. Shoqëria target është një mjet për qëllime të veçanta (SPV) i promovuar nga grupi Lanco në vitin 2006 për ndërtimin e projektit të hidrocentralit. Shoqëria u krijua për të zbatuar projekte hidroelektrike në rrjedhën e lumit prej 76 MW të quajtura Phata Byung në lumin Mandakini në Uttarakhand (India Veriore).

Shoqëria Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited, nuk ka prani dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Shoqëria target Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited është në rolin e koncesionarit për projektin hidroenergjitik 76 MW (2x38) në shtetin e Uttarakhand të Indisë së Veriut, për një periudhë 45-vjeçare. Projekti pësoi dëmtime të rënda për shkak të vërshimeve të menjëhershme në Qershor të vitit 2013, duke rezultuar në një tejkalim të konsiderueshëm të afateve dhe kostove të parashikuara. Si rrjedhojë, shoqëria nuk arriti të mbledhte kapitalin e nevojshëm për të finalizuar zbatimin e projektit. Huadhënësit që financuan projektin morën kontrollin de facto të drejtimit të shoqërisë, duke qenë se ajo nuk arriti të shlyente kreditë e saj.

Aktualisht shoqëria është referuar pranë Gjykatës Kombëtare Tregtare (NCLT) në përputhje me Kodin e Indisë për Paaftësinë Pagueuse dhe Falimentimin(IBC), duke u shpallur në gjendje paaftësie paguese dhe duke iu nënshtruar Procesit të Zgjidhjes së Paaftësisë Pagueuse sipas legjisllacionit Indian.

Referuar Letrës së Qëllimit, datë 25 shkurt 2022, Plani i Zgjidhjes i dorëzuar nga Statkraft IH Holdings AS, është hedhur në votim nga Komiteti i Kreditorëve dhe është miratuar sipas kërkesave të Kodit të Paaftësisë Pagueuse dhe Falimentimit me 100% të drejtave të votimit. Profesionisti i Zgjidhjes së Paaftësisë Pagueuse për shoqërinë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited, i ka propozuar shoqërisë Statkraft IH Holdings AS të procedojë me depozitimin e Planit të Zgjidhjes për miratimin nga Gjykata Kombëtare e Ligjit për Shoqëritë në përputhje me dispozitat e IBC.

Pavarësisht përmbajtjes së Planit të Zgjidhjes, asnjë pjesë e Planit të Zgjidhjes nuk do të bëhet efektive ose e detyrueshme derisa Plani i zgjidhjes do të miratohet nga Komiteti i Kreditorëve të shoqërisë(COC) në përputhje me depozitat e IBC dhe Autoritetit Gjykyes në tërësi.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aksioneve në shoqërinë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS, e cila do të bëhet efektive me vendimin e

Gjykatës. Transaksioni është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë së rinovueshme, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit, nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS. Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, shoqëria mëmë e Statkraft Group, i cili është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited, është një shoqëri private e kufizuar në kuota, e themeluar në Indi, e krijuar për të zbatuar projekte hidroelektrike në rrjedhën e lumit Mandakani (India Veriore). Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Transaksioni i njoftuar ende nuk ka përfunduar, pasi pritet vendimi i Gjykatës Kombëtare Tregtare. Bazuar në dokumentacionin e depozituar, përqendrimi i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS, me kusht që, shoqëria Statkraft IH Holdings AS të marrë dhe të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës vendimin përfundimtar të Gjykatës Kombëtare Tregtare, dega Allahabad, Indi, mbi blerjen e aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 882, Datë 22.04.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FAZUA GMBH NGA SHOQËRIA PORSCHE INVESTMENTS GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e Investimit” të datës 20 Janar 2022, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Porsche Investments GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: blerjen dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, si dhe mbajtjen, menaxhimin dhe shitjen e këtyre pjesëmarrjeve.

Porsche Investments GmbH është një filial i shoqërisë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft (Porsche), shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, e cila operon në prodhimin, zhvillimin dhe shitjen kryesisht të makinave sportive me performancë të lartë dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbime financiare për automjetet. Porsche është një filial që zotërohet tërësisht dhe kontrollohet në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime, dhe Porsche Leasing SHPK një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj..

Pala shitëse: Shitësit janë 8 persona fizikë, shtetas të huaj dhe 8 shoqëri të huaja, të regjistruara në shtetin gjerman dhe aksionarë të shoqërisë target Fazua GmbH.

Target: Fazua GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e koncepteve dhe sistemeve të drejtimit të automjeteve në industrinë e biçikletave dhe komponentëve të tyre individualë, si dhe biçikletave të plota.

Targeti nuk ka filiale dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Shoqëria blerëse Porsche Investments GmbH, shitësit dhe shoqëria target Fazua GmbH kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshja e Investimit”, më datë 20 Janar 2022. Referuar kësaj marrëveshjeje, aksionarët aktualë të shoqërisë target [_____].

Pas regjistrimit të [_____]. Pas implementimit të transaksionit, shoqëria target Fazua GmbH do të zotërohet plotësisht nga Porsche Investments GmbH.

Referuar marrëveshjeve si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të sistemeve të lëvizjes së biçikletave elektronike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.

Porsche Investments GmbH është një filial i shoqërisë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft. Porsche, i cili zotërohet tërësisht dhe kontrollohet në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), shoqëria mëmë e grupit Volkswagen. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Fazua GmbH nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 883, Datë 18.05.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË DISA ASETEVE TË SHOQËRIVE TË CAKTUARA TË GRUPIT AUTO-HOLDING DRESDEN NGA SHOQËRIA VGRDD GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.05.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërive të caktuara të Grupit Auto-Holding Dresden nga shoqëria VGRDD GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërive të caktuara të Grupit Auto-Holding Dresden nga shoqëria VGRDD GmbH.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërive të caktuara të Grupit Auto-Holding Dresden nga shoqëria VGRD GmbH, nëpërmjet një SPV të krijuar me emrin VGRDD GmbH.

Referuar dokumentit “Kontrata e blerjes së shoqërisë në lidhje me operationet e biznesit të shoqërive të caktuara të Auto-Holding Dresden Group”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: VGRDD GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti tregtimin e pjesëve motorike, aksesoreve, funksionimin e dyqaneve të riparimit, marrjen me qera të automjeteve dhe mirëmbajtjen e tyre.

VGRDD GmbH është një filial në pronësi të plotë të VGRD GmbH, pjesë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Pala shitëse: Auto-Holding Dresden GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: tregtimin me pakicë të automjeteve të reja dhe të përdorura, pjesë këmbimi dhe aksesorë të të gjitha llojeve, riparimin e automjeteve dhe të gjitha llojet e shërbimeve të makinave, marrja e kredive, kontratat e qerasë dhe sigurimet, marrja me qera e automjeteve, funksionimi i një lavazhi dhe menaxhimi i investimeve të aktiveve. Auto-Holding Dresden GmbH zotëron 100% Auto-Holding Dresden Service GmbH.

Auto-Holding Dresden GmbH dhe Auto-Holding Dresden Service GmbH zotërohen 50% nga Znj. Grit Meisel dhe 50% nga Z. Jan Wirthgen, të cilët janë garantuesit e kësaj kontrate. Auto-Holding Dresden GmbH dhe Auto-Holding Dresden Service GmbH janë shoqëri shërbimi, të cilat aktualisht ofrojnë shërbime për shoqëritë operative, që zotërohen indirekt nga Auto-Holding Dresden GmbH.

Auto-Holding Dresden GmbH zotëron 94% të shoqërisë FORSAN Grundstücks-Vermietungsgesellschaft mbH & Co. Objekt Dresden KG.

Aktivitetet e Target konsistojnë në disa asete të shoqërive të Grupit Auto-Holding Dresden, të cilat përfshijnë aktivitetin e shpërndarjes me pakicë të automjeteve për pasagjerë, automjeteve tregtare, pjesë këmbimi si dhe shërbime mirëmbajtje dhe riparime, në zonën e Dresden, Gjermani.

II. Përqendrimi

Më datë 14 mars 2022, shitësat, garantuesit dhe shoqëria VGRDD GmbH kanë lidhur “Kontratën e blerjes së shoqërisë në lidhje me operacionet e biznesit të shoqërive të caktuara të Auto-Holding Dresden Group”.

Referuar kësaj kontrate, operacionet e biznesit të shitësve operativë, të përbëra nga aktivitetet fikse dhe afatshkurtra si dhe nga marrëdhëniet kontraktuale dhe të drejtat e tjera të shitësve, si dhe nga disa aktive dhe marrëdhënie kontraktuale të shoqërive ofruese të shërbimit, shiten dhe transferohen tek blerësi. Përveç këtyre, pasuria e paluajtshme e nevojshme për blerje, merren me qira nga shitësit dhe FORSAN ose merren qiratë ekzistuese ose nën-qiratë nga palët e treta.

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.

Asetet e target mundësojnë ushtrimin e aktivitetëve vendase të shitësit në tregun e shpërndarjes me pakicë të automjeteve të reja për pasagjerë dhe automjeteve të lehta tregtare, të mjeteve të përdorura motorike, në tregun e shpërndarjes me pakicë të pajisjeve origjinale të pjesëve të këmbimit dhe të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit, marrëdhënie kontraktore, kontrata qiraje. Përmes këtyre aseteve shitësi kryen aktualisht aktivitetet e tij në tregun përkatës. Bazuar në sa më sipër, asetet e target mund të kategorizohen si biznese me prezencë në treg, të cilave mund t’ju atribuohet xhiroja e shitësit në tregun përkatës.

Pas implementimit të transaksionit të propozuar, blerësi VGRDD do të bëhet zotëruesi i vetëm i aseteve që përbëjnë aktivitetin e target, duke ushtruar në këtë mënyrë kontroll të plotë mbi aktivitetin e target.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shpërndarjes me pakicë i automjeteve të reja për pasagjerë dhe automjeteve të lehta tregtare, i mjeteve të përdorura motorike, tregu i shpërndarjes me pakicë të pajisjeve origjinale të pjesëve të këmbimit dhe tregu i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit, marrëdhënie kontraktore, kontrata qiraje, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar synon blerjen e disa aseteve të shoqërive të caktuara të Grupit Auto-Holding Dresden nga shoqëria VGRDD GmbH.

VGRDD GmbH është një filial në pronësi të plotë të VGRD GmbH e cila është pjesë e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Grupi Auto-Holding Dresden GmbH nuk ka aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërive të caktuara të Grupit Auto-Holding Dresden nga shoqëria VGRDD GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 884, Datë 18.05.2022

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ
NDËRMARRJES NOA CONTROL SHPK NË TREGUN E OFRIMIT TË SHËRBIMIT
TË KONTROLLIT LIGJOR TË INSTRUMENTEVE MATËSE, NËPËRMJET
VERIFIKIMIT TË INSTRUMENTEVE SHPËRNDARËSE TË KARBURANTIT DHE
GAZIT TË LËNGSHËM, ME DETYRIME PËR NDËRMARRJEN NOA CONTROL
SHPK DHE REKOMANDIME PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.05.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me detyrime për ndërmarrjen NOA CONTROL SHPK dhe rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Bazë ligjore: Neni 8, 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).
Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm; dhe,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit paraprak;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Bazuar në ankesat e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrjet: ALCERT SHPK, ECIT SHPK, SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK, ST2 SHPK dhe MFM SHPK, kundrejt ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, lidhur me abuzimin me pozitën dominuese të kësaj ndërmarrje në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN, janë kryer procedurat e vlerësimit të ankesës në respektim të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

2. Në kuadër të vlerësimit të kësaj ankese, në zbatim të nenit 29/1 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 28 dhe 29 të Rregullores së Funkcionimit të Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 539/1 prot, datë 29.12.2021, “Kërkesë për takim”, u është kërkuar ndërmarrjeve ankuese që të paraqiten pranë AK-së për zhvillimin e një takimi lidhur me rastin, si dhe depozitimi i dokumentacionit shtesë/provave ku ato mbështesin pretendimet e tyre.
3. Në përgjigje të këtyre kërkesave u paraqitën pranë AK-së dy prej ndërmarrjeve ankuese ALCERT SHPK dhe SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK, me të cilat u zhvillua takimi gjatë të cilit u mbajt proces-verbali i datës 10.01.2022, “Mbi takimin e mbajtur në kuadër të vlerësimit të ankesës së paraqitur lidhur me pasojat në treg të krijimit të pozitës dominuese të shoqërisë NOA CONTROL SH.P.K në sektorin e karburanteve”, si dhe u depozitua informacion shtesë, protokolluar pranë AK me nr. 17 prot, datë 10.01.2022 dhe nr. 17/1 prot, datë 10.01.2022.
4. Nga vlerësimi i ankesës, rezultoi se sjellja e ndërmarrjes koncesionare NOA CONTROL SHPK mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese që zotëron ky koncesionar në ofrimin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me pasojë kufizimin e konkurrencës në tregjet e lidhura si ato të shërbimit të inspektimit të depozitave të GLN-së dhe karburanteve, lëshimit të Vërtetimit Teknik dhe çertifikimit të punonjësve që përdorin pajisje nën presion, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
5. Bazuar sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës së paraqitur nga ndërmarrjet, lidhur me pasojat në treg të krijimit të pozitës dominuese të shoqërisë NOA CONTROL SHPK”, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, me VKK-në nr. 863, datë 15.02.2022 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN, për të parë nëse ka shkelje të nenit 9, të Ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, për periudhën kohore nga 1 Janar 2019 deri në 31 Janar 2022.
6. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të Vendimit nr. 863, datë 15.02.2022 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr.17/10, datë 22.02.2022, “Autorizim inspektorësh”, Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, si dhe ndërmarrjeve të tjera që operojnë në tregjet e shërbimit të inspektimit të depozitave të karburanteve dhe GLN-së, lëshimit të Vërtetimit Teknik dhe çertifikimit të punonjësve, si Organe të miratuara nga MIE.
7. Në zbatim të këtij Vendimi, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja nën hetim NOA CONTROL SHPK, ndërmarrjet e tjera që operojnë si Organe të Miratuara nga MIE, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

II. Kontrata e Koncesionit

8. Kontrata e Koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, është nënshkruar më datë 21.08.2019 midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Kontraktues, Shoqërisë NOA CONTROL SHPK (Koncesionari) dhe shoqërisë NOA INSPECT SHPK (Shoqëria Koncesionare). Për realizimin e kësaj Kontrate, Koncesionari NOA CONTROL SHPK ka themeluar Shoqërinë Koncesionare NOA INSPECT SHPK.
9. Nëpërmjet kësaj Kontrate Koncesioni, *Koncesionarit i është dhënë e drejta e vetme dhe ekskluzive të kryejë shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës koncesionare. Zona gjeografike e këtij koncesioni është gjithë territori i Republikës së Shqipërisë dhe periudha e koncesionit është 20 vjet.*
10. Referuar nenit 14 të Kontratës së Koncesionit, tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit ose gazit të lëngshëm do të jenë sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (ish Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Ministrit të Financave nr. 2, datë 08.02.2013 “Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të drejtorisë së përgjithshme të metrologjisë”. Këto tarifa shërbimi nuk mund të jenë më të ulta se ato ta parashikuara në këtë udhëzim dhe mund të ndryshohen vetëm me propozim të arsyetuar të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare. Sipas pikës 14.2 të këtij neni, frekuenca e verifikimit të rregullt të instrumenteve matës do të jetë jo më pak se 2 (dy) herë në vit për çdo Subjekt.
11. Referuar nenit 14.3, palët mund të bien dakord për rritjen e frekuencës së verifikimit të rregullt të instrumenteve matës, për një periudhë tranzitore, në rast se: a) Gjatë kryerjes së verifikimeve në terren rezultojnë se mbi 5% e totalit të instrumenteve matës të verifikuara rezultojnë me probleme; dhe/ose b) Databazat, të dhënat dhe fletët e punës që do të dorëzohen nga Autoriteti Kontraktues sipas dispozitave të kësaj kontrate, përmbajnë pasaktësi ose janë të paplota. Rritja e frekuencës mund të bëhet *për të gjithë subjektet e detyruara ose për zona ose subjekte të detyruara të caktuara.*
12. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 646, datë 09.08.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika I, ka vendosur: *“I. T’i kërkojë shoqërisë NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje e cila fiton të drejta të veçanta nëpërmjet Draft Kontratës së koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.*
13. KK me Vendimin nr. 646/2019 i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rishikimin e pikës 3 të nenit 14 të draft kontratës koncesionare (sipas pikës II/2 të dispozitivit të VKK), pasi ka konstatuar se kjo pikë për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja NOA CONTROL SHPK kufizon konkurrencën (pika 23 e pjesës argumentuese të VKK nr. 646/2019). Në kontratën e miratuar ky rekomandim nuk është reflektuar.

14. Aktualisht kjo kontratë është në fazën e operimit. Shoqëria koncesionare ka realizuar 100% investimin në përputhje me grafikun e investimeve dhe specifikat teknike, investim i cili është verifikuar dhe miratuar edhe nga ana e Autoritetit Kontraktor. Kryerja e shërbimit në terren ka filluar më datë 31 Mars 2020, pas miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktues të investimeve të kryera.
15. Ndërmarrja NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje me të drejta të veçanta, ka detyrimin e zbatimit të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 gjatë ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e konkurrencës

III.1 Tregu përkatës

16. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK/NOA INSPECT SHPK dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e saj në treg, tregu përkatës në këtë rast është: Tregu i ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm (GLN) nga ndërmarrja NOA CONTROL SHPK në territorin e Republikës së Shqipërisë.
17. Ndërmarrja Koncesionare NOA CONTROL SHPK krahas shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN nëpërmjet shoqërisë NOA INSPECT SHPK, si “Organ Vlerësim Konformiteti” (OMVK) i miratuar nga MIE në kuadër të Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, ofron edhe shërbime të tjera për subjektet e shitjes me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm, ndër të cilat:
- Lëshimin e vërtetimeve teknike për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportit, tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre;
 - Inspektime periodike për pajisjet/instalimet nën presion (të naftës e GLN-së);
 - Çertifikimin e punonjësve/personave që përdorin pajisje nën presion, ku përfshihen edhe punonjësit që përdorin distributorët/pompat e GLN-së; si dhe
 - Vlerësimi i konformitetit të projekteve teknike dhe teknologjike për produktet/pajisjet/instalimet nën presion;
- shërbime këto të cilat ofrohen gjithashtu edhe nga subjekte të tjera konkurrense/Organe të Miratuara nga MIE.
18. Në këto kushte, ofruesit e tjerë të këtyre shërbimeve (Organet e Miratuara), nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, pretendojnë se janë vendosur në pozita inferiore dhe të pafavorshme konkurrence, për shkak të pozitës dominuese të NOA CONTROL SHPK në ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN, pozitë e cila i shërben ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK për të zgjeruar gjithashtu pozitën e saj në të gjithë gamën e mundshme të shërbimeve inspektuese që ajo ofron ndaj subjekteve të tregtimit të karburanteve.
19. Për sa më sipër, për efekt të analizës në raport është marrë në analizë sjellja e ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK kundrejt Organeve të tjera të Miratuara që ofrojnë shërbimet inspektuese të lartpërmendura.

III.3 Vlerësimi i pozitës dominuese të ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK/ NOA INSPECT SHPK

20. Konçesionari NOA CONTROL SHPK, nëpërmjet Shoqërisë Koncesionare NOA INSPECT SHPK ka ekskluzivitet në ofrimin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë zotëron 100% të pjesëve të tregut përkatës.
21. Referuar pjesëve të tregut të ndërmarrjes, barrierave për hyrjen në treg, konkurrencës potenciale, fuqisë kundërvepruese të blerësve, si dhe fuqisë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Konçesionari NOA CONTROL SHPK, nëpërmjet Shoqërisë Koncesionare NOA INSPECT SHPK ka pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm (GLN).

III.4 Vlerësimi i sjelljes së shoqërisë koncesionare NOA INSPECT SHPK

22. Duke qenë se gjatë inspektimeve të kryera nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar një sjellje antikonkurrenuese nga ana e ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese NOA INSPECT SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit të instrumenteve matës janë analizuar të dhënat në lidhje me numrin e instrumenteve matës të ngelur ose frekuencën (periodicitetin) e kryerjes së verifikimeve të instrumenteve matës dhe tarifave të aplikuara për ofrimin e këtij shërbimi.
23. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes koncesionare NOA INSPECT SHPK në lidhje me frekuencën (periodicitetin) e kontrollit të instrumenteve konstatohet se nuk ka një metodologji për llogaritjen e përqindjes së totalit të instrumenteve matës të verifikuar që rezultojnë me probleme, referuar edhe rekomandimit të dhënë me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 646/2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika II/2/a).
24. Nga verifikimi i faturave të shitjes të administruara nga ndërmarrja NOA INSPECT SHPK gjatë periudhës hetimore, rezulton se kjo shoqëri ka ofruar shërbimin e kontrollit ligjor të instrumentit matës në fushën e karburanteve dhe gazit të lëngshëm me tarifave të miratuara sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (ish Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Ministrit të Financave nr. 2, datë 08.02.2013 “Për tarifave dhe pagesat e shërbimeve të drejtorisë së përgjithshme të metrologjisë”.
25. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjes NOA INSPECT SHPK, referuar frekuencës së inspektimeve dhe tarifave të aplikuara nuk konstatohen shenja të abuzimit me pozitën dominuese nga kjo ndërmarrje në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

III.5 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK si ndërmarrje OMVK.

26. Gjatë hetimit kanë rezultuar rreth 14 ndërmarrje që operojnë në tregun e inspektimit dhe certifikimit për shoqëritë e tregtimit të karburanteve dhe GLN-së, si organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit (OMVK), të licencuara nga MIE, nga të cilat ndërmarrja Swiss Approval Albania SHPK është ndërmarrja e

parë e licencuar e ndjekur nga ndërmarrja NOA Control SHPK. Në periudhën hetimore vërehet një trefishim i numrit të ndërmarrjeve të cilat janë licencuar nga MIE si ndërmarrje OMVK për ofrimin e shërbimeve të ndryshme, sipas Aktit të Miratimit.

27. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit, për efekt të analizës së sjelljes së ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK si OMVK, kundrejt konkurrentëve të tij, është marrë në analizë:- tregu i ofrimit të shërbimit të lëshimit të vërtetimeve teknike për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportit, tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre, si shëbimi me sensitiv duke qënë se është periodik dhe sjell të ardhura më të larta krahasuar me shërbimet e tjera; si dhe, - tregu i ofrimit të shërbimit të inspektive periodike për pajisjet/instalimet nën presion (të naftës e GLN-së), të cilat janë shërbime që ofrohen nga një numër më i madh ndërmarrjesh dhe realizohen periodikisht me afat 6 muaj dhe 1 vjeçar.
28. Pjesa e tregut të ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në ofrimin e lëshimit të vërtetimit teknik në vitin 2020 ka pësuar një rënie prej rreth 11% (nga 31.6% në 20.5%), ndërsa në vitin 2021 ka arritur në nivelin 35%, duke mos zotëruar pozitë dominuese në ofrimin e këtij shërbimi. *Nga kjo konstatohet se pozita në tregun e koncesionit nuk ka ndikuar në rritjen e fuqisë së ndërmarrjes NOA CONTROL në tregun e ofrimit të shërbimit të vërtetimit teknik.*
29. Për periudhën hetimore vërehet një trefishim i numrit të ndërmarrjeve në tregun e ofrimit të shërbimit të lëshimit të vërtetimit teknik, pavarësisht rritjes shumë të vogël të subjekteve të cilat kërkojnë paisjen me këtë vërtetim.
30. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut të ndërmarrjeve OMVK si një nga treguesit kryesor për vlerësimin e pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve në treg rezulton se ndërmarrja Swiss Approval SHPK ka pjesë tregu mbi 40% gjatë periudhës hetimore për shërbimin e lëshimit të vërtetimit teknik. Ky vlerësim është realizuar në kuadër të analizimit të pjesëve të tregut, pavarësisht faktit që subjektet ankuese nuk janë subjekte nën hetim.
31. Për vitin 2021 vërehet se indeksi HHI ka pësuar një ulje krahasuar me vitin 2019 si pasojë e hyrjes së ndërmarrjeve të reja në treg, konkretisht nga 3 në 7 ndërmarrje të licensuara si OMVK. Edhe pse treguesit e përqendrimit HHI dhe CR3 rezultojnë të lartë, nuk vërehet qëndrueshmëri e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg.
32. Nga analizimi i faturave të ndërmarrjeve rezulton se cmimet minimale dhe maksimale të aplikuara për shërbimin e lëshimit të vërtetimit teknik variojnë nga 20.000 deri në 76.000 lekë dhe janë të ndryshme edhe nga njëra ndërmarrje në tjetrën, por edhe brenda të njëjtës ndërmarrje pasi marrësi i shërbimit, subjektet ndaj të cilave lëshohet ky vërtetim teknik, janë të shpërndara në të gjithë territorin e RSH, duke bërë që kostot e shërbimit, ku një zë të rëndësishëm ze dhe transporti, të jenë të ndryshme.
33. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut vërehet se ka një numër të madh ndërmarrjesh për të cilat realizohet inspektimi i paisjeve/instalimeve nën presion. *Pjesa e tregut të ndërmarrjes Noa Control Shpk si në periudhën para marrjes së koncesionit, ashtu dhe pas, vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulta nga 1-3% të tregut.* Gjithshtu vërehet se pjesët e tregut të ndërmarrjeve ndryshojnë përgjatë periudhës hetimore, pra nuk ka një qëndrueshmëri në pjesët e tregut të ndërmarrjeve.

34. Edhe pse treguesit e përqendrimit rezultojnë të lartë, nuk vërehet qëndrueshmëri e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në shërbimin e inspektimit të paisjeve nën presion, si dhe në treg kanë hyrë konkurrentë të rinj vit pas viti.
35. Nga analizimi i faturave të ndërmarrjeve rezulton se tarifat minimale dhe maksimale të aplikuara për shërbimin e inspektimit të paisjeve/instalimeve nën presion variojnë nga 5.400 deri në 30.000 lekë dhe janë të ndryshme edhe nga njëra ndërmarrje në tjetrën, por edhe brenda të njëjtës ndërmarrje në varësi të madhësisë së depozitave/paisjeve të inspektuara të GLN-së dhe naftës.
36. Nga krahasimi i cmimeve të shërbimit të lëshimit të vërtetimit teknik dhe shërbimit të inspektimit të paisjeve/instalimeve nën presion nga ndërmarrjet OMVK, vërehet se ato janë të ndryshme dhe me diferenca nga njëra tjetra, sjellje e cila nuk përbën shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 3 pika 4 dhe nenit 4 të Ligjit nr 9121/2003.
37. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut të ndërmarrjeve OMVK rezulton se asnjë nga ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbimin e lëshimit të vërtetimit teknik dhe inspektimit të paisjeve/instalimeve nën presion nuk zotëron pozitë dominuese në treg në kuptim të nenit 8 të Ligjit 9121/2003.
38. Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK rezulton se: pozita dominuese që zotëron kjo shoqëri në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm (GLN), nuk ka ndikuar në rritjen e fuqisë së kësaj ndërmarrje si OMVK në tregun e ofrimit të shërbimeve inspektuese ndaj subjekteve të tregtimit të karburanteve duke mos aplikuar çmime të padrejta dhe kushte të padrejta tregtimi në kryerjen e këtyre shërbimeve.
39. Sa më sipër, referuar analizës së të dhënave të administruara gjatë hetimit nuk rezulton të ketë shenja të kufizimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN-së, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d), nenin 26, nenin 43, pika 5, dhe nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN-së;
- II. Detyrimin e ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje me të drejta të veçanta nëpërmjet Kontatës së koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- III. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si vijon:

- a) *Miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare NOA Inspect SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos;*
- b) *Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe çdo shërbimi tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare NOA Inspect SHPK, të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës;*
- c) *Miratimin e një metodologjie për vendosjen e përqindjes për instrumentat matës të verifikuara që rezultojnë me probleme, duke implementuar rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës ex ante me vendimin nr. 646/2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika II/2/a).*

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 885, Datë 27.05.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË INTENTA GMBH NGA SHOQËRIA CARIAD SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.05.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Intenta GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Intenta GmbH nga shoqëria CARIAD SE

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes dhe transferimit të të gjitha aksioneve të shoqërisë Intenta GmbH tek shoqëria CARIAD SE.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen dhe transferimin e të gjitha aksioneve në Intenta GmbH”, datë 31 Mars 2022, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: CARIAD SE është një shoqëri evropiane, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike për industrinë automobilistike dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, veçanërisht në industrinë e programimit.

CARIAD SE është një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesorëve të tyre dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen, i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me

objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Pala shitëse: Z. Heiko Cramer dhe Z. Basel Fardi janë persona fizikë, shtetas të huaj, të regjistruar në shtetin gjerman dhe aksionarë të shoqërisë target Intenta GmbH.

Target: Intenta GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman. Intenta GmbH zhvillon dhe integron softuer specifik që janë përbërës të sistemeve (të avancuara) për asistencën e shoferëve dhe përbërës të navigatorëve, që ndihmojnë shoferin nëpërmjet përdorimit të sensorëve dhe algoritmeve. Në veçanti Intenta GmbH është aktive në zhvillimin dhe integrimin e zgjidhjeve softuerike që kanë të bëjnë me përpunimin dhe analizën e imazheve të të dhënave të sensorëve, bashkimin e të dhënave të sensorëve dhe njohjen dhe zbulimin e objektit / personit nëpërmjet zhvillimit të algoritmit.

Intenta GmbH nuk ka aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Shoqëria blerëse CARIAD SE, shitësit Z. Heiko Cramer dhe Z. Basel Fardi dhe shoqëria target Intenta GmbH kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje për blerjen dhe transferimin e të gjitha aksioneve në Intenta GmbH”, më datë 31 Mars 2022.

Referuar kësaj marrëveshjeje, shitjet e shoqërisë gjenerohen kryesisht në dy fusha biznesi: 1) [.....] dhe 2) [.....].

Pjesë e transaksionit do të jetë vetëm [.....]. Të gjitha aktivitetet e tjera të biznesit të shoqërisë Intenta GmbH, do të transferohen tek [.....]. Pas implementimit të transaksionit, blerësi do të zotërojë të gjitha aksionet e shoqërisë Intenta GmbH dhe si rrjedhojë kontrollin e plotë mbi shoqërinë target.

Referuar marrëveshjeve si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i zhvillimit të softuerëve për industrinë e automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Intenta GmbH nga shoqëria CARIAD SE, një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruara indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Intenta GmbH nuk ka aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Intenta GmbH nga shoqëria CARIAD SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 886, Datë 27.05.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË VUB GENERALI DOCHODKOVA SPRAVCOVSKA SPOLOCNOST’, A.S NGA SHOQËRIA VŠEOBENCNÁ ÚBEROVÁ BANKA, A.S”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.05.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost’, a.s nga shoqëria Všeobecná úberová banka, a.s.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës e Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost’, a.s nga shoqëria Všeobecná úberová banka, a.s.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost’, a.s nga shoqëria Všeobecná úberová banka, a.s.

Referuar “Marrëveshjes së blerjes së aksioneve”, datë 05 Prill 2022; “Marrëveshjes së aksionerëve e amenduar dhe e ripërtërirë”, datë 05 Prill 2022, palët janë:

Pala blerëse: Všeobecná úberová banka, a.s/VÚB, a.s, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt aktiviteti: Pranimi i depozitave, dhënia e kredive, menaxhimi i të ardhurave të klientit në llogari të tij, duke përfshirë edhe shërbimet e konsulencës në lidhje me të, leasing financiar, dhënia e garancive, hapja dhe validimi i letrave të kreditit, dhënia e shërbimeve të konsulencës në fushën e biznesit, ndërmjetësimi financiar, etj.

VÚB, a.s, zotërohet nga Intesa Sanpaolo Holding International S.A, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, pjesë e grupit Intesa SanPaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane.

Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, në regjistrin e Grupeve Bankare. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, etj; veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve.

Pala shitëse: Generali Česká pojišťovna a.s është një institucion financiar, i organizuar sipas legjislacionit çek. Generali Česká pojišťovna a.s është anëtar i Grupit Generali, i menaxhuar nga Assicurazioni Generali SPA, e regjistruar në shoqëritë italiane të sigurimeve dhe risigurimeve.

Shoqëria Target: VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s, është një shoqëri aksionare, sipas legjislacionit të Sllovakisë, dhe objekt aktiviteti: Krijimi dhe menaxhimi i fondeve të pensionit për qëllime të kursimeve pensionale të pleqërisë.

Intesa Sanpaolo SPA dhe Assicurazioni Generali SPA, duke vepruar përmes filialeve të tyre përkatëse sllovaqe Všeobecná úberová banka, a.s dhe Generali Česká pojišťovna a.s, [.....].

VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s , nuk është aktive në Shqipëri dhe nuk ofron ndonjë shërbim në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Shoqëria VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s. është një sipërmarrje e përbashkët e krijuar dhe e kontrolluar [.....]. Që nga data e “Marrëveshjes së aksionerëve e amenduar dhe e ripërtërirë”, secila Všeobecná úberová banka, a.s Generali dhe Česká pojišťovna a.s zotërojnë në shoqëri [.....].

Sipas marrëveshjes së blerjes së aksioneve, blerësi dhe shitësi dëshirojnë të riorganizojnë aksionet e tyre në shoqërinë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s., dhe në fund të procesit, blerësi do të zotërojë [.....] dhe shitësi do të zotërojë [.....] në shoqërinë target.

Shitësi Generali Česká pojišťovna dëshiron të shesë dhe blerësi Všeobecná úberová banka, a.s dëshiron të blejë aksionet që përfaqësojnë [.....] në kapitalin aksionar të regjistruar të shoqërisë target sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshje.

Si pjesë e transaksionit të propozuar, më datë 05 prill 2022, palët Intesa Sanpaolo SPA, Assicurazioni Generali SPA, Všeobecná úberová banka, a.s dhe Generali Česká pojišťovna a.s, hynë në “Marrëveshjen e aksionerëve, e amenduar dhe e ripërtërirë”, që pasqyron [.....], duke i dhënë shoqërisë VÚB, a.s [.....].

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e aksioneve të shoqërisë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s nga shoqëria Všeobecná úberová banka, a.s., e cila sjell si pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë target, në përmbushje të nenit 10 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Referuar pasqyrave financiare, palët në marrëveshje plotësojnë kriterin e xhiros të përcaktuar në nenin 12 të ligjit.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i produkteve të fondeve të pensionit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit mbi shoqërinë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s nga shoqëria Všeobecná úberová banka, a.s.

Všeobecná úberová banka, a.s. (VÚB, a.s.) zotërohet nga Intesa Sanpaolo S.p.A, shoqëria mëmë e Intesa Sanpaolo Group, e cila është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, shoqëri që vepron në tregun e shërbimeve bankare.

VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, duke qenë se Intesa Sanpaolo S.p.A gjeneron të ardhura në Shqipëri në sektorin e shërbimeve bankare por jo në tregun e produkteve të fondeve të pensioneve dhe Target nuk realizon asnjë të ardhur në Shqipëri. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë VUB Generali dochodkova spravcovska spolocnost', a.s nga shoqëria Všeobecná úberová banka, a.s.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 887, Datë 10. 06 . 2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BANCA COMERCIALĂ “ENERGBANK” S.A. NGA SHOQËRIA AS IUTECREDIT EUROPE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10. 06. 2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. nga shoqëria AS IuteCredit Europe.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. nga shoqëria AS IuteCredit Europe.

VËREN SE :

IV. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi disa blerjeve të njëpasnjëshme të aksioneve të shoqërisë Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. në bursën Moldave, nga shoqëria AS IuteCredit Europe.

Referuar dokumenteve që vërtetojnë marrjen e kontrollit mbi shoqërinë e synuar Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. nga shoqëria AS IuteCredit Europe (vërtetime të lëshuara nga agjenti i blerësit në bursën Moldave), palët janë:

Pala blerëse: AS IuteCredit Europe është një shoqëri holding e grupit të shoqërive IuteCredit i cili ofron kredi konsumatore dhe shërbime personale financimi nëpërmjet shoqërive të kontrolluara 100% nga grupi në Moldavi, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Bullgari, Bonje dhe Hercegovinë. AS IuteCredit Europe është përgjegjëse për menaxhimin strategjik të Grupit IuteCredit.

Shoqëritë e kontrolluara brenda grupit zbatojnë proceset e përcaktuara nga AS IuteCredit Europe dhe u ofrojnë shërbime konsumatorëve.

AS IuteCredit Europe është prezente në Shqipëri nëpërmjet dy shoqërive të kontrolluara prej saj: IuteCredit Albania SHA dhe Velox Pay SHPK.

IuteCredit Albania SHA është një institucion financiar mikrokredie, ndërsa Velox Pay SHPK është licencuar nga Banka e Shqipërisë si institucion i parasë elektronike, por ende nuk kryen asnjë aktivitet tregtar.

Pala shitëse: Aksionarët që shesin aksionet e shoqërisë Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. ndahen në disa grupe: Grupi i aksioneve të thesarit; grupi i aksioneve ankand; grupi i aksioneve të bllokuara; entitete ligjore dhe persona fizikë.

Target: Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. / B.C “ENERGBANK” S.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me legjislacionin e Moldavisë dhe aktive në tregun financiar, e cila ofron shërbime bankare për konsumatorët dhe për shoqëritë tregtare si: shërbime kredie, këmbim valutor, online-banking dhe pagesa me karta bankare etj.

B.C “ENERGBANK” S.A. nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi

Më datë 16 korrik 2021, shoqëria AS IuteCredit Europe depozitoi zyrtarisht pranë Bankës Qendrore Moldave një kërkesë për të blerë 100% të kapitalit të shoqërisë B.C “ENERGBANK” S.A. Më datë 30 dhjetor 2021, Banka Qendrore Moldave autorizoi shoqërinë AS IuteCredit Europe për të blerë deri në 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë B.C “ENERGBANK” S.A.

Duke filluar nga data 10 janar 2022 e në vazhdim, AS IuteCredit Europe ka kryer disa blerje të njëpasnjëshme të aksioneve të shoqërisë B.C “ENERGBANK” S.A. në bursën Moldave. Më datë 19 prill 2022, AS IuteCredit Europe zotëronte në total 1 891 681 aksione, që përbëjnë 94.58% të kapitalit aksionar të shoqërisë B.C “ENERGBANK” S.A. Pjesa tjetër e aksioneve do të zotërohet nga Balcolcolm S.A dhe nga personat fizikë.

Referuar marrëveshjeve si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

V. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare, por duke qenë se transaksioni mund të mos ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. nga shoqëria AS IuteCredit Europe.

AS IuteCredit Europe është një shoqëri holding e grupit të shoqërive IuteCredit, i cili është prezente në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj: IuteCredit Albania SHA dhe Velox Pay SHPK. IuteCredit Albania SHA është një institucion financiar mikrokredie, ndërsa Velox Pay Shpk është licencuar nga Banka e Shqipërisë si institucion i parasë elektronike, por ende nuk kryen asnjë aktivitet tregtar.

Banca Comerciala “ENERGBANK” SA është një bankë tregtare, e cila nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

3. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Banca Comercială “ENERGBANK” S.A. nga shoqëria AS IuteCredit Europe.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 888, Datë 10.06.2022

“MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.779, DATË 04.03.2021 “MBI MONITORIMIN E VENDIMIT NR. 723, DATË 17.11.2020 “PËR MBYLLJEN, ME KUSHTE DHE DETYRIME, TË PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË SEKTORIN BANKAR PËR BANKËN RAIFFEISEN, BANKËN KOMBËTARE TREGTARE, BANKËN CREDINS DHE BANKËN INTESA SANPAOLO” PËR PERIUDHËN 2019-2020 DHE DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, shqyrtoi çështjen me

Objekti: “Mbi zbatimin e vendimit nr. 779, datë 04.03.2021 “Mbi monitorimin e vendimit nr.723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo” për periudhën 2019-2020 dhe dhënien e disa rekomandimeve”.

Baza Ligjore: Neni 2, neni 4, neni 24, germa d) dhe neni 28 germa d), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e vendimit nr. 779, datë 04.03.2021, nga shoqëritë Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins dhe Banka Intesa Sanpaolo,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 779, datë 04.03.2021 “Mbi monitorimin e vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo” për periudhën 2019-2020 dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi:

1. T’i rekomandojë Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo që gjatë miratimit të politikave të tyre monetare:

- a. të eliminojë kostot penguese, duke lehtësuar lëvizshmërinë e klientit mes bankave;
- b. të zgjerojë gamën e shërbimeve dhe produkteve nëpërmjet platformave digjitale.

2. Monitorimin e sjelljes së Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo, për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.

Në zbatim të nenit 28, germa d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës (ligji), nëpërmjet shkresës nr. 244 prot., datë 01.04.2022 “Kërkesë për informacion”, drejtuar bankave objekt monitorimi, është kërkuar informacion lidhur me zbatimin e pikës 1 të vendimit.

– Me shkresën nr. 244/1 prot., datë 12.04.2022 “Kthim-përgjigje shkresës Tuaj “Kërkesë për informacion” me nr.244 prot, datë 01.04.2022”, *Banka Intesa Sanpaolo* deklaron që, lidhur me eliminimin e kostove penguese, banka nuk aplikon asnjë komision dhe penalitet si për mbylljen e llogarive dhe depozitave (përveç rasteve kur mbyllja e tyre bëhet brenda një afati kohor tremujor nga data e çeljes së tyre), ashtu edhe në rastin e transferimit të kredive në banka të tjera.

Lidhur me shërbimet dhe produktet e reja nëpërmjet platformave digjitale, *Intesa Sanpaolo Bank* informon se është në një fazë të avancuar të dixhitalizimit të plotë të të gjithë gamës së produkteve dhe shërbimeve për klientët.

– Nëpërmjet shkresës nr. 244/3 datë 14.04.2022 “Kthim përgjigje shkresë nr.244”, *Banka Raiffeisen* deklaron se, nuk aplikon tarifa dhe komisione për mbylljen e llogarive rrjedhëse, llogarive të kursimit dhe kartave të debitit për klientë individë. Banka aplikon komisione për transferimin e balancave në një bankë tjetër dhe për tërheqjet cash. Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë, banka aplikon penalitetin kontraktor si në rastet kur mbyllet me fondet e klientit, ashtu edhe në rastin kur mbyllet me një kredi të akorduar nga një bankë tjetër.

Lidhur me llogaritë rrjedhëse për klientin biznes, komisioni që aplikohet, është kostoja administrative e bankës për mbylljen e llogarisë së klientit.

Banka Raiffeisen, gjatë periudhës së monitorimit, ka pasur në fokus zgjerimin e ofrimit të produkteve online nëpërmjet platformave të saj digjitale.

– Nëpërmjet shkresës nr. 244/4 prot., datë 15.04.2022 “Kthim përgjigje shkresës tuaj, nr.244 prot, datë 01.04.2022 “Kërkesë për informacion”, *Banka Kombëtare Tregtare*, lidhur me eliminimin e kostove penguese për lehtësimin e lëvizshmërisë së klientit mes bankave, ka bërë të mundur mbylljen pa komision të llogarive bankare, kur kërkesa e klientit për mbyllje bëhet tre muaj pas çeljes së tyre. Gjithashtu, janë ulur kostot e transferimit të fondeve në euro drejt bankave të tjera brenda vendit, të cilat më parë konsideroheshin si transferta ndërkombëtare.

Lidhur me gamën e shërbimeve dhe produkteve të ofruara nëpërmjet platformave digjitale, *Banka Kombëtare Tregtare*, gjatë periudhës 2021- Mars 2022 ka prezantuar shërbimet/produktet e reja në platformën digjitale.

– Nëpërmjet shkresës nr. 244/5 prot., AK datë 15.04.2022 “Kthim përgjigje”, *Banka Credins* thekson se ka lançuar oferta të reja shërbimesh dhe paketa të kombinuara produktesh ku komisionet janë zero ose mbahet si një i vetëm për të gjithë paketën.

Gjithashtu, *Banka Credins* ka ulur kostot e transferimit të fondeve në euro drejt bankave të tjera brenda vendit, të cilat më parë konsideroheshin si transferta ndërkombëtare. Komisionet e aplikuar për transfertat nëpërmjet e-banking, janë 50% më të ulëta se ato të realizuara në sportelet e bankës.

Lidhur me gamën e shërbimeve dhe produkteve të ofruara nëpërmjet platformave digjitale, *Banka Credins* thekson se do të vazhdojë të jetë në linjë me të gjitha prioritetet e përcaktuara në strategjinë e vet duke u fokusuar në avancimin digjital dhe edukimin e vazhdueshëm të publikut për shërbimet e tyre tradicionale dhe inovative.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se *Banka Raiffeisen*, *Banka Kombëtare Tregtare*, *Banka Credins* dhe *Banka Intesa SanPaolo*, ofrojnë paketa me produkte /shërbime të kombinuara, për të plotësuar më mirë nevojat e individëve për shërbime bankare, të cilat kanë çuar në uljen e tarifave dhe komisioneve të tyre,

Buletini Zyrtar i Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës por nuk kanë ndërmarrë ndryshime në politikat e tyre në lidhje me komisionet e transferimit të kredive mes bankave apo penaltitetet e likuidimit të parakohshëm të kredisë (me përjashtim të Bankës Intesa SanPaolo).

Bankat kanë orientuar shërbimet e tyre drejt përdorimit të platformave digjitale, shtimit të numrit të shërbimeve, uljen e kostove (pothuajse të gjitha shërbimet e ofruara janë pa komisione) dhe edukimit të publikut për shërbimet e reja digjitale, duke plotësuar rekomandimet e dhënë në pikën 1, të vendimit nr. 779, datë 04.03.2021 “Mbi monitorimin e vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo” për periudhën 2019-2020 dhe dhënien e disa rekomandimeve”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 2, neni 4, neni 24 germa d) dhe nenit 28 germa d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të mbyllë procedurën e monitorimit të zbatimit të vendimit 779, datë 04.03.2021 “Mbi monitorimin e vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo” për periudhën 2019-2020 dhe dhënien e disa rekomandimeve”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 889, Datë 10.06.2022

“MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 755, DATË 09.12.2020 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA) NGA SHOQËRIA KASTRATI GROUP SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e vendimit të KK nr. 755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK (TIA) nga shoqëria Kastrati Group SHA”

Baza Ligjore: Nenet 2, neni 8 dhe 9, neni 24, germa d), dhe neni 28, germa d) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Udhëzimi “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK (TIA) nga shoqëria Kastrati Group SHA”

VËREN SE :

Procedura

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK (TIA) nga shoqëria Kastrati Group SHA”, vendosi:

- 1- Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA.
- 2- Kastrati Group SHA, në cilësinë e shoqërisë blerëse duhet të respektojë nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- 3- Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë për një periudhë 1 vjeçare sjelljen e ndërmarrjes në treg.

Ne zbatim të nenit 28, germa d) të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës (ligji), Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 534 prot., datë 17.12.2021 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 143 prot., datë 28.02.2022 “Kërkesë për informacion”, i kërkoi TIA informacionin për të vlerësuar zbatimin e pikës 2 të vendimit të Komisionit të Konkurrencës. Me shkresën nr. 239 prot., datë 30.03.2022 “Kthim përgjigje të shkresës suaj datë 17.12.2021, nr. prot. 534”, TIA depozitoi informacionin në lidhje me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në vendim.

Vlerësimi i zbatimit të vendimit.

Referuar pjesës arsyetuese të vendimit të KK nr. 755, datë 09.12.2020, Komisioni i Konkurrencës evidentoi se: *Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) zotëron pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore dhe shërbimet e asistencës në tokë, pasi ka ekskluzivitetin “de facto” të fluturimeve ndërkombëtare drejt/nga Shqipëria. Për këtë arsye, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës duhet të zbatojë kushte të barabarta për veprime të njëjta tregtare me palët që do të operojnë në këtë aeroport (shoqëritë ajrore përfshirë dhe ato me kosto të ulët (low cost).*

Me vendimin e mësipërm Komisioni i Konkurrencës, detyroi shoqërinë Kastrati Group SHA, në cilësinë e shoqërisë blerëse, të respektojë nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”. Zbatimi i detyrimit nga shoqëria Kastrati Group SHA, u realizua nëpërmjet vlerësimit të veprimtarisë së shoqërisë Tirana International Airport, shoqëria target në transaksionit.

Në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit, ratifikuar me Ligjin nr. 9312 datë 11.11. 2004, TIA ka të drejtën, fuqinë dhe autoritetin që përgjatë kohëzgjatjes së Koncesionit, ndër të tjera të drejtojnë, mirëmbajnë, menaxhojnë dhe zhvillojnë Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, i cili prej muajit dhjetor 2020 zotërohet 100% nga shoqëria Kastrati Group SHA.

Qeveria e Shqipërisë, referuar klauzolës 2.1.a (ii), (ix) dhe (xii) të Marrëveshjes së Koncesionit, i njeh TIA-s të drejtën e vetme dhe ekskluzive që gjatë Afatit të Koncesionit të administrojë dhe të operojë lëvizjen në tokë dhe shërbimet e lidhura, të drejtën për të zhvilluar marketing ekskluziv për Aeroportin si dhe të drejtën për zhvillimin tregtar ekskluziv në Zonën e Koncesionit.

Në përputhje me Kontratën e Koncesionit, TIA gëzon të drejtën për të lidhur drejtpërdrejt kontrata me shoqëritë ajrore dhe përdoruesit e Aeroportit, duke respektuar kushtet e tregut dhe duke ndjekur politika jo-diskriminuese në ofrimin e shërbimeve aeroportuale dhe komerciale (i.e, Klauzola 18.2 (*Kushtet e Tregut*), Klauzola 18.3 (*Qiratë dhe marrëveshje të tjera Kontraktore*) dhe Klauzola 18.4 (*Mosdiskriminimi*).

Po kështu aktiviteti i TIA-s bëhet konform kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe organizatave ndërkombëtare të tilla si: IATA, ICAO, ACI, Konventa e Çikagos etj.

Mbështetur në informacionin e depozituar nga TIA, konstatohet se:

- Gjatë dy viteve të fundit, TIA ka shtuar përpjekjet për hartimin dhe zbatimin e politikave të marketingut ndaj të gjitha kompanive ajrore. Kompania me kosto të ulët Wizz Air ka rritur ndjeshëm praninë e saj në Aeroportin e Tiranës, me 6 avionë të bazuar në TIA dhe planifikon të shtojë dhe dy të tjerë gjatë vitit 2022. Transportuesit shqiptarë Albawings dhe Air Albania kanë rritur gjithashtu praninë e tyre në TIA dhe kanë plane për zgjerim destinacionesh.
- TIA shërben si nyje (Hub) për 11 kompani ndërkombëtare që ofrojnë shërbime tranziti, duke shtuar mundësinë e fluturimeve tranzit ku pasagjeret zgjedhin aeroportin ku duan të kryejnë tranzitin në bazë të

orarit, çmimit, kohës së pritjes. Kompanitë LOT dhe Fly Dubai kanë shtuar mundësinë e fluturimeve tranzit për në Amerikën e Veriut, Azi dhe Australi (Fly-Dubai në kod share me Emirates).

- Grupi Lufthansa, si një ndër grupet më dominuese në aviacion, fluturon nga TIA nëpërmjet hub-it të Frankfurtit, Munihut, Vjenës dhe nga Nëntori 2021 nëpërmjet hub-it të Zvicrës.
- TIA ka negociuar dhe ka paraqitur një plan biznesi pranë British Airways (BA) dhe duke bërë të mundur ndryshimin e aeroportit ku BA operon, nga London GatWick në Heathrow.
- TIA gjatë vitit 2021 ka nisur punimet për ofrimin e shërbimit aeroportual ekskluziv për avionët charter (General Aviation Area), shërbim që do të jetë plotësisht operativ gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Avionët charter privat do të kenë mundësi të operojnë nga ky terminal i veçantë, i cili plotëson të gjitha kriteret aeroportuale si pikë e re udhëtimi.
- TIA ka hartuar një strategji për rritjen e numrit të turizmit, sidomos atij që gjenerohet jashtë Shqipërisë (incoming). TIA ka kryer një sërë vizitash pranë zyrave qendrore të operatorëve turistikë të huaj dhe të linjave ajrore përkatëse, ku ka prezantuar potencialin e turizmit shqiptar, mundësitë e zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm që është dhe fillimi i TIA-s për të patur turizëm gjatë të gjithë vitit. TIA ka organizuar FAM TRIPS (udhëtime familjarizimi) në Shqipëri të operatorëve të huaj, ku ne fokus të axhendës kanë qenë takimet business to business. Në këtë mënyrë janë shtuar destinacionet dhe shifrat e turizmit nga Polonia, Ukraina, Kroacia, Republika Çeke, vendet nordike. Tregjet e reja si Arabia Saudite, Egjipti, dhe Bullgaria pritet të konsolidohen më tej gjatë sezonit veror 2022-2023. Gjithashtu TIA ka punuar me Aegean Airline për të bërë të mundur fluturime direkte në ishujt turistike të Kretës dhe Rodos. Ky treg është rritur me 25%.

Sipas statistikave të depozituara, rezulton se numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet TIA gjatë vitit 2021 të jetë rritur me rreth 45% krahasuar me vitin 2020, ndërkohë që numri i avionëve në nisje nga TIA për vitin 2021 është rritur me rreth 58% krahasuar me vitin 2020.

Në funksion të shërbimeve të infrastrukturës aeroportuale dhe shërbimet e asistencës në tokë, si dhe sipas Shtojcës 7 të Marrëveshjes së Koncesionit, TIA ka të përcaktuar listën e shërbimeve që ofron aeroporti dhe pagesat/ tarifën për këto shërbime, të cilat që prej datës së fillimit janë klasifikuar në: Shërbimi në Tokë, i Uljes dhe Ngritjes; Shërbimi për Pasagjerë; Shërbimi i Kargos; Shërbimi i Parkimit të Avionit dhe Shërbimi i Ndriçimit të Aerodromit;

Me Ligjin nr. 16/2021 datë 08.02.2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të Marrëveshjes së Koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana International Airport”, SHPK, “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë", ratifikuar me ligjin nr.9312, datë 11.11.2004”, të ndryshuar, është miratuar një ndryshim në pikën 2 të Shtojcës 7 “Pagesa për Pasagjerët” duke reduktuar pagesën bazë për pasagjerët nga 12.5 EUR në 10 EUR për personat mbi 12 vjeç dhe nga 5 EUR në 3 EUR për fëmijë nga 2 deri në 12 vjeç, e cila është reflektuar pranë IATA Reservation System, si platforma ndërkombëtare e shitblerjes së biletës.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se Tirana International Airport SHA (TIA), ka respektuar detyrimin për të zbatuar kushte të barabarta për veprime të njëjta tregtare me palët që do të operojnë në këtë aeroport (shoqëritë ajrore përfshirë dhe ato me kosto të ulët (low cost), duke ndërmarrë politika të zgjerimit të kompanive të fluturimit dhe rritje të numrit të destinacioneve, operon me tarifa të rregulluara nga qeveria shqiptare.

Shoqëria Kastrati Group SHA, nëpërmjet shoqërisë Tirana International Airport SHA, ka respektuar detyrimin e përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 755, datë 09.12.2020, për të mos abuzuar me pozitën dominuese në tregun

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të mbyllë procedurën e monitorimit mbi zbatimin e vendimit të KK nr. 755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK (TIA) nga shoqëria Kastrati Group SHA”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 890, Datë 10.06.2022

**“MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT MBI KUFIZIMET E KONKURRENCËS “SIPAS OBJEKTIT”
PËR QËLLIME TË PËRCAKTIMIT TË MARRËVESHJEVE ME RËNDËSI TË VOGËL”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anetar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,
- Draft udhëzimit

VËREN SE :

1. Qëllimi i Udhëzimit lidhur me marrëveshjet me rëndësi të vogël” (Rregullorja “de Minimis”) është ofrimi i sigurisë për ato lloj marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve, për të cilat Autoriteti i Konkurrencës (AK) vlerëson se nuk sjellin efekte mbi konkurrencën në treg. Sqaron kufizimet “sipas objektit” në marrëveshjet midis joko-kurrentëve, të cilat mund të dallohen në rastet kur ato lidhen me ndarjen e tregut sipas territorit dhe/ose grupit të klientëve ose me kufizimet në aftësinë e blerësit për të përcaktuar çmimin e rishitjes.
2. Përcaktimin e tre kufizimeve klasike "sipas objektit" në marrëveshjet midis konkurrentëve janë fiksimi i çmimeve, kufizimi i prodhimit dhe ndarja e tregut

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Miratimin e Udhëzimit “Mbi kufizimet e konkurrencës” sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 891, Datë 14.06.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË AUTOZENTRUM SPORT AS NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit i realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Autozentrum Sport AS nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Autozentrum Sport AS nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Autozentrum Sport AS nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Referuar “Marrëveshjes së blerjes së aksioneve”, datë 02 Maj 2022, palët janë:

Pala blerëse: *Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft*, është një shoqëri publike, e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti: Prodhimin dhe shitjen automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, si dhe pjesëve dhe montimeve për produkte të tilla dhe të tjera teknike, etj.

Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft është bërë pjesë e Grupit Volkswagen që nga viti 2009.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen, operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Pala shitëse: *Autozentrum Holding AS*, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me objekt aktiviteti: Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç motorëve të avionëve, shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave/shitja me pakicë e karburanteve të automobilave, shitje makinash dhe mjetesh motorike të lehta, etj.

Shoqëria Target: *Autozentrum Sport AS*, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. Shoqëria *Autozentrum Sport AS*, është një shoqëri distribucioni automjetesh me fokus në importin dhe distribucionin e automjeteve, pjesëve dhe aksesorëve të markës Porche përmes një rrjeti tregtuesish të autorizuar të Porche në Norvegji. Shoqëria target zotërohet tërësisht nga shitësi.

Autozentrum Sport AS nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri. Aktiviteti i saj është i kufizuar vetëm brenda territorit të Norvegjisë.

II. Përqendrimi

Referuar “Marrëveshjes së blerjes së aksioneve”, datë 02 Maj 2022, shitësi ka titullin dhe pronësinë e plotë mbi aksionet. Aksionet përbëjnë [.....] të kapitalit të emtuar të shoqërisë *Autozentrum Sport AS* dhe janë të emtuara në mënyrë të vlefshme dhe të shlyera plotësisht. Shoqëria *Autozentrum Sport AS* pas transaksionit do të riemërtohet [.....].

Blerësi dëshiron të blejë nga shitësi dhe shitësi dëshiron të shesë tek blerësi [.....] sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Në të njëjtën datë, palët kanë lidhur një marrëveshje aksionarësh për të rregulluar më tej termat dhe kushtet e bashkëpunimit në lidhje me tregtimin me shumicë dhe pronësinë e përbashkët të shoqërisë pas mbylljes së transaksionit.

Data e mbylljes së transaksionit të njoftuar do të jetë [.....]. Aksione shitjeje [.....] do të blihen nga blerësi sipas kushteve të kësaj marrëveshje.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të [...] aksioneve në shoqërinë *Autozentrum Sport AS* nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Transaksioni është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës konsiderohet tregu i distribucionit/furnizimit me shumicë të automjeteve për pasagjerë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Autozentrum Sport AS nga shoqëria Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft.

Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, kompania mëmë e Volkswagen Group. Grupi Volkswagen është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj: Porsche Leasing SHA dhe Porsche Albania SHPK.

Autozentrum Sport AS, nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri.

Pas implementimit të transaksionit, target do të zotërohet [...]Porsche dhe [...] nga Autozentrum Holding AS.

Transaksioni i propozuar nuk do të ketë asnjë ndikim në tregjet përkatëse në çdo juridiksion përveç se në Norvegji. Porsche nuk është aktiv si importues/shitës me shumicë, në vendet ku ka marrëveshje ekskluzive të importit dhe shpërndarjes me palë të treta. Porsche nuk është aktiv si shitës me shumicë i produkteve Porsche në Norvegji.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

5. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Autozentrum Sport AS nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 892, Datë 14.06.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT / JV NGA SHOQËRITË SLOVENSKÁ SPORITEL’ŇA, A.S., VŠEOBECNÁ ÚVEROVÁ BANCA, A.S., TATRA BANKA, A.S., ČESKOSLOVENSKÁ OBCHODNÁ BANKA, A.S. DHE 365. BANK, A.S.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione plota, nga shoqëritë Slovenská sporitel’ňa,a.s., Všeobecná úverová banka,a.s, Tatra banka, a.s.,. Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank,a.s.,

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, të kontrolluar në mënyrë të përbashkët nga shoqëritë Slovenská sporitel’ňa,a.s., Všeobecná úverová banka,a.s, Tatra banka, a.s., Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank,a.s.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, nga shoqëritë Slovenská sporitel’ňa,a.s.,Všeobecná úverová banka,a.s, Tatra banka, a.s., Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank,a.s.,

Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe “Fletë Afatit (term sheet)”, të nënshkruar më datë 21 Korrik 2021, palët janë:

Pala 1: Slovenská sporitel’ňa, a.s., është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt aktiviteti: Aktivitetet dhe shërbimet bankare, pranimi i depozitave, kreditimi, tregtimi për llogari të vet,

ofrimi i informacionit bankar, ofrimi i shërbimeve të konsulencës për biznesin, ofrimi i shërbimeve investuese, etj.

Shoqëria Slovenská sporiteľňa, a.s., zotërohet nga aksionari i vetëm Erste Group Bank AG, e krijuar sipas legjislacionit të Austrisë, me seli në Vjenë.

Pala 2: *Všeobecná úverová banka, a.s.*, është një shoqëri aksionare, e themeluar në Bratislavë, Sllovaki, me objekt aktiviteti: Pranimi i depozitave, dhënia e kredive, menaxhimi i të ardhurave të klientit në llogari të tij, duke përfshirë edhe shërbimet e konsulencës në lidhje me të, leasing financiar, dhënia e garancive, dhënia e shërbimeve të konsulencës në fushën e biznesit, ndërmjetësimi financiar, etj.

Shoqëria Všeobecná úverová banka, a.s., zotërohet nga aksionari i vetëm, shoqëria Intesa Sanaolo Holding International S.A., e cila është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA u ofron kompanive, klientëve institucionalë e privatë shërbime e produkte bankare.

Pala 3: *Tatra banka, a.s.*, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit sllovak, me objekt aktiviteti: Pranimi i depozitave, kreditimi, ofrimi i shërbimeve të pagesave dhe shlyerja, ofrimi i shërbimeve të investimit, tregtimi për llogari të saj, qira financiare, dhënie e garancive, hapja dhe konfirmimi i letrave të kredisë, ofrimi i shërbimeve të konsulencës për biznesin, ndërmjetësimi financiar etj.

Shoqëria Tatra banka, a.s. është njësi organizative e Grupit Raiffeisen, e pranishme në Shqipëri nëpërmjet një filiali të zotëruar indirekt prej saj, Raiffeisen Bank SHA, me objekt aktiviteti kryerjen e shërbimeve financiare dhe bankare.

Pala 4: *Československá obchodná banka, a.s.*, është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt aktiviteti: Pranimi i depozitave, kreditimi, ofrimi i shërbimeve investuese, tregti për llogari të vet, etj.

Shoqëria Československá obchodná banka, a.s., zotërohet nga aksionari vetëm shoqëria KBC Bank N.V., i krijuar sipas legjislacionit të Belgjikës.

Pala 5: *365.bank,a.s.*, është një shoqëri aksionare, e regjistruar në Bratislavë, Sllovaki dhe me objekt aktiviteti: Pranimi i depozitave, huadhënia, ofrimi i shërbimeve të pagesave dhe shlyerja, ofrimi i shërbimeve të investimit, etj.

Shoqëria 365.bank,a.s., është degë e bankës Postova.

Shoqëria Target: Ndërmarrja e përbashkët (JV) Monologi s.r.o (NewCo) është një shoqëri e krijuar nga legjislacioni sllovak me themelues Slovenská sporiteľňa, a.s., Všeobecná úverová banka, a.s, Tatra banka, a.s., Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank,a.s, me objekt të aktivitetit të biznesit: Aktivitet brokerimi në fushën e tregtisë, shërbimeve, prodhimit, blerja e mallrave për qëllime të shitjes tek konsumatori përfundimtar ose një operator tjetër i tregtisë, shërbime kompjuterike dhe të përpunimit të të dhënave, pasuri me qira që lidhen me ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga ato bazë në lidhje me marrjen me qira, dhënia me qira e pasurive të luajtshme, veprimtaritë e konsulentëve të biznesit, organizativ dhe ekonomik, shërbime administrative, shërbimet e reklamimit dhe marketingut, kërkimet e tregut dhe sondazhi i opinionit publik dhe kontabiliteti.

Aktualisht JV NewCo nuk kryen asnjë aktivitet tregtar, nuk posedon asnjë aset dhe punonjës dhe nuk zotëron licencën e nevojshme për të kryer aktivitet e synuara të biznesit.

I. Përqendrimi

Palët (Partnerët) që kanë themeluar një JV NewCo, kanë nënshkruar një Fletë Afati (term sheet) më datë 21 korrik 2021, me synimin për të përcaktuar parimet kryesore dhe të dhënat thelbësore që Partnerët dëshirojnë të përfshijnë në Marrëveshjen e Partneritetit.

Marrëveshja e Partneritetit nënkupton një marrëveshje me shkrim ndërmjet Partnerëve që rregullon të drejtat dhe detyrimet reciproke të partnerëve në sipërmarrjen e përbashkët, nënkupton krijimin e një shoqëri për qëllime të veçanta, e themeluar nga Partnerët me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e veprimtarive, të cilat në mënyrë thelbësore do të krijohen dhe do të ekzistojnë në përputhje me parimet e Flete Afatit dhe Marrëveshjes së Partneritetit.

Partnerët deklarojnë se janë të vetëdijshëm se nënshkrimi i Fletë Afatit nga Partnerët nuk nënkupton lidhjen e marrëveshjes së Partneritetit dhe as lidhjen e ndonjë dokumenti tjetër. Partnerët konfirmojnë dhe deklarojnë se, Fletë Afati dhe negociatat pasuese të Partnerëve do të kryhen nga Partnerët me synimin për të lidhur Marrëveshjen e Partneritetit, jo më vonë se data 31 dhjetor 2022.

Nëse marrëveshja e partneritetit nuk lidhet në afatin e përcaktuar, Partnerët konsiderohen se nuk janë më të interesuar për ta lidhur atë në përputhje me parimet e përcaktuara në Fletë Afat

Kushti për lidhjen e Marrëveshjes së Partneritetit, brenda periudhës së mësipërme të Fletë Afatit, është që të merren të gjitha konfirmimet ose miratimet e nevojshme rregullatorë, maksimumi deri më 30 qershor 2022, përveç rastit nëse Partnerët bien dakord në Marrëveshjen e Partneritetit për efektin e shtyrjes së kësaj të fundit pas marrjes së të gjitha konfirmimeve ose miratimeve të nevojshme rregullatorë.

Gjithçka e shënuar në këtë Fletë Afatesh do të rregullohet nga ligji sllovak.

Mbi shumën e kontributeve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë JV, çdo partner do të zotërojë respektivisht: (i) Slovenská sporiteľňa, a.s. 26% të pronësisë, (ii) Všeobecná úverová banka, a.s. 30% të pronësisë, (iii) Tatra banka, a.s. 26% të pronësisë, (iv) Československá obchodná banka, a.s. 10% të pronësisë dhe (v) 365.bank, a.s. 8% të pronësisë.

Transaksioni i synuar konsiston në krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, të kontrolluar në mënyrë të përbashkët nga shoqëritë, Slovenská sporiteľňa, a.s., Všeobecná úverová banka, a.s., Tatra banka, a.s., Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank, a.s, e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes së Partneritetit.

Transaksioni është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve me paranë CASH, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Slovenská sporitel'ňa,a.s.,Všeobecná úverová banka,a.s, Tatra banka, a.s., Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank,a.s.,

Všeobecná úverová banka, a.s. (VÚB, a.s.) është anëtare e grupit bankar Intesa Sanpaolo, i cili është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, shoqëri që vepron në tregun e shërbimeve bankare.

Tatra Banka a.s., është anëtare e Grupit Ndërkombëtar Raiffeisen dhe si rrjedhojë është në pronësi dhe kontroll të tërthortë nga Raiffeisen Bank International AG. Grupi Raiffeisen është prezent dhe realizon xhiro në Shqipëri përmes Raiffeisen Bank Albania SHA, një shoqëri që vepron në tregun e shërbimeve bankare.

Palët e tjera nuk kanë degë apo filial dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Sipas palëve, Monilogi s.r.o., (JV NewCo) do të ushtrojë veprimtarinë e saj vetëm në Slloveni dhe nuk do të jetë prezent në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Transaksioni i njoftuar ende nuk ka përfunduar, pasi pritet depozitimi i një marrëveshje përfundimtare të funksionimit të ndërmarrjes së re/JV të krijuar (Marrëveshja e Partneritetit), marrëveshje e cila do të lidhet, pasi të jenë marrë miratimet nga rregullatorët, brenda datës 31 dhjetor 2022.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Slovenská sporitel'ňa,a.s.,Všeobecná úverová banka,a.s, Tatra banka, a.s., Československá obchodná banka, a.s. dhe 365.bank,a.s.,me kusht që, pala njoftuese të marrë dhe të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës Marrëveshjen e Partneritetit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 893, Datë 14.06.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FORD ROMANIA SA NGA SHOQËRIA FORD OTOSAN NETHERLANDS B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Ford Romania SA nga shoqëria Ford Otosan Netherlands B.V.,.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Ford Romania SA nga shoqëria Ford Otosan Netherlands B.V.,.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Ford Romania SA nga shoqëria Ford Otosan Netherlands B.V.,.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Shit-Blerje”, datë 14 Mars 2022, palët janë:

Blerësi: Ford Otosan Netherlands B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Holandës, me objekt aktiviteti: Prodhim mjetesh motorike, prodhim i pjesëve elektrike dhe elektronike dhe aksesorëve për automjete, asete financiare.

Ford Otosan Netherlands B.V zotërohet tërësisht nga Ford Otomotiv Sanayi A.Ş., një shoqëri anonime, e organizuar sipas ligjeve të Turqisë dhe me fushë aktiviteti: Prodhim automobilash dhe automjetesh të ngjashme, e pakufizuar në veprimtarinë e saj. Ford Otomotiv Sanayi A.Ş, kontrollohet me pjesëmarrje të përbashkët, plotësisht funksionale, midis Ford Motor Company dhe Koç Holding A.Ş. Shoqëria Ford Otosan nuk ka filiale, degë apo përfaqësi në Shqipëri, por realizojnë të ardhura

nëpërmjet një distributori të pavarur të saj.

Shitësi: Ford Capital B.V, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas ligjeve të Holandës. Ford Capital BV është një kompani që merret me mbledhjen e fondeve, e cila realizohet duke emetuar letra komerciale dhe duke ofruar letra me vlerë të borxhit. Ford Capital operon ndërkombëtarisht.

Target: Ford Romania SA, është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Rumanisë, me objekt aktiviteti kryesor: Prodhimi i automjeteve të transportit rrugor, etj.

Shoqëria Ford Romania SA zotërohet nga shoqëria Ford Motor Company US, e krijuar sipas legjislacionit të SHBA-së, me 0.00000015603% të aksioneve dhe nga shoqëria Ford Capital B.V, e krijuar sipas legjislacionit të Holandës me 99.9999984397% të aksioneve.

II. Përqendrimi

Më datë 14 Mars 2022, ndërmjet palëve Ford Capital B.V (shitësi), Ford Otosan Netherlands B.V (blerësi), Ford Otomotiv Sanayi A.Ş.(mëma blerësit) është lidhur “Marrëveshje shit-bletje”, në lidhje me shoqërinë Ford Romania SA(target).

Referuar kësaj marrëveshje [.....]

Para ekzekutimit, [.....].

Përfundimi i transaksionit të propozuar kushtëzohet, ndër të tjera, me marrjen e autorizimit të përqendrimit nga Komisioni Evropian. Rasti i përfuturit të kontrollit të shoqërisë Ford Romania SA nga shoqëria Ford Otosan Netherlands B.V. është njoftuar pranë Komisionit Evropian më datë 17.05.2022, me numër çështje M 10739 dhe pritet që Komisioni Evropian të shprehet me vendim deri në datë 24.06.2022. Marrja e autorizimit të përqendrimit në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Tunizi, Turqi, Ukrainë dhe Arabinë Saudite renditet, gjithashtu, si kusht paraprak për përfundimin e transaksionit të propozuar. Në varësi të marrjes së autorizimeve përkatëse të kontrollit të përqendrimit, palët synojnë të realizojnë transaksionin e propozuar brenda datës 1 korrik 2022.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë më blerjen e aksioneve në shoqërinë Ford Romania SA nga Ford Otosan Netherlands B.V, transaksion i cili do të sjellë një ndryshim të kontrollit të shoqërisë target, Shoqëria target, pas transaksionit do të kontrollohet në mënyrat indirekt nga Ford Otomotiv Sanayi A.Ş, ku kjo e fundit kontrollohet bashkërisht nga Ford Motor Company dhe Koç Holding A.Ş. Transaksioni është në përputhje në nenin 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të automjeteve, por duke qenë se transaksioni, aktualisht nuk ka ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Ford Romania SA nga shoqëria Ford Otosan Netherlands B.V. Ford Romania SA dhe Ford Otosan nuk kanë filiale, degë apo përfaqësi në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Ford Romania SA nga shoqëria Ford Otosan Netherlands B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 894, Datë 24.06.2022

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES VODAFONE ALBANIA SHA NË TREGUN E SHËRBIMEVE CELULARE: TREGU ME SHUMICË I TERMINIMIT TË THIRRJEVE NDËRKOMBËTARE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.06.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Neofone SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me 404 prot., datë 08.09.2021, ka depozituar ankesën mbi abuzimin me pozitën dominuese nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
2. Në vijim të ankesës së depozituar, me anë të shkresës nr. 404/1 prot., datë 20.12.2021 “Mbi shqyrtimin e ankesës”, në bazë të nenit 29/1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar si dhe nenit 28, 29 të Rregullores së Funkcionimit të Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Neofone SHPK në datën 06.01.2022 është ftuar për një seancë dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës për tu dëgjuar mbi shkeljet e pretenduara.
3. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 862, datë 31.01.2022 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, për periudhën kohore nga 10 Prill 2015 deri në 31 Dhjetor 2021.

4. Në zbatim të këtij vendimit, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar ndërmarrjes Vodafone Albania SHA dhe AKEP.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
6. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është një shërbim që kryhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është brenda juridiksionit territorial dhe lëndor si dhe kompetencave të AKEP për të vendosur mënyrën e rregullimit të tij duke garantuar barazi, mosdiskrimin dhe konkurrencë të lirë dhe të ndershme në përputhje me Ligjin nr. 9918/2008 dhe legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës.
7. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është një shërbim me shumicë, i cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t’u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular.
8. Ofrimi i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare është i pamundur të kryhet nëse nuk ofrohet si input aksesit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, për ti dërguar tek abonenti fundor nëpërmjet përdorimit të rrjetit publik të operatorëve mobile.
9. Sipas AKEP, asnjë operator celular, nuk kërcënohet nga operatorë të tjerë të mundshëm që të hyjnë në tregun individual të secilit prej tyre dhe të ofrojnë shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e një operatori tjetër celular, pasi ky shërbim mund të ofrohet vetëm nga operatori i rrjetit përkatës.
10. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania.
11. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrja Vodafone Albania SHA është e përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
12. Treg përkatës përkufizohet tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania, i cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t’u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

II.2 Vlerësimi i pozitës dominuese

13. Përkufizimi i pozitës dominuese është dhënë në nenin 3, pika 5 të Ligjit nr. 9121/2003, i cili përcakton se: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato

të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”

14. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003.
15. Kriteret kryesore për vlerësimin e pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit janë: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; barrierat e hyrjes në tregun përkatës; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve/konsumatorëve; varësia ekonomike e furnizuesve të blerësve; zhvillimi i rrjetit shpërndarës; karakteristika të tjera të tregut përkatës.
16. Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe fikse kanë qenë nënrrregullim nga AKEP në periudhën shtator 2008 - shkurt 2012. Rregullimi i tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në periudhën e cituar është kryer nga AKEP duke i përcaktuar ato të barabarta me MTR për thirrjet kombëtare. Arsyetimi i këtij rregullimi është dhënë në dokumentet përkatëse të AKEP (më parë ERT). Në vijim të këtyre vendimeve të AKEP, ofertat referencë të interkoneksionit të tre operatoreve me FNT (AMC, Vodafone dhe Albtelecom fiks), përmbanin në mënyrë eksplicite detyrimin për secilin nga tre operatorët me FNT, që të ofrojnë terminim të thirrjeve ndërkombëtare, operatoreve vendas me tarife të njëjtë si edhe terminimi i thirrjeve kombëtare.
17. AKEP me vendimet nr. 1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, vendosi nxjerrjen nga rregullimi të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom (rrjeti fiks) me efekte nga data 1.02.2012.
18. Në analizën e tregut të vitit 2012, AKEP me Vendimet nr. 2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.07.2012 kreu de-rregullimin e plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke e nxjerrë këtë shërbim nga përkufizimi i tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare duke e hequr edhe detyrimet e tjera për FNT si dhënie akses, mos-diskriminim dhe transparencë, me efekt nga data 1.09.2012. Ky qëndrim është mbajtur nga AKEP edhe në analizën e tregut të vitit 2014 si dhe në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në dhjetor 2016.
19. Bazuar në analizat e tregut deri në vitin 2018, AKEP ka përcaktuar se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare nuk është në të njëjtin treg përkatës si edhe termini i thirrjeve kombëtare për shkak të dimensionit gjeografik por në të dy tregjet secili nga operatorët është me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) pasi ka monopolin e terminimit në rrjetin e vet të thirrjeve kombëtare ose ndërkombëtare.²
20. Ndërmarrja Vodafone Albania sipër përkufizimit nga AKEP zotëron monopolin në tregun me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare. Vlera e indeksit HHI (Herfindahl-Hirschman Index) për periudhën nën hetim, bazuar në pjesët e tregut në rastin e një ndërmarrje me pozitë dominuese, është shumë e lartë, në vlerën 10 000. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 9, të ligjit nr.

² Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 11, datë 16.06.2020, fq. 54/99

9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka një pozitë dominuese duke patur 100% të tregut përkatës. Duke u bazuar në ligj dhe në udhëzimin përkatës të pozitës dominuese, por edhe në praktikat më të mira të Komisionit Europian dhe të OECD, monopoli në këtë rast Vodafone Albania SHA, është një mundësi potenciale që të shkaktojë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun përkatës

21. Ndërmarrja Vodafone Albania është një ndërmarrje e autorizuar si ofrues i rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe i autorizuar për të tranzituar trafik ndërkombëtar brenda Shqipërisë sipas parashikimeve të ligjit shqiptar në fuqi.
22. Referuar analizës së fundit të AKEP nëpërmjet vendimit nr. 11, datë 16.06.2020 dhe shkresës së AKEP nr. 104/11 prot., datë 19.05.2022, tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nuk është në rregullim nga AKEP që nga viti 2012, nuk ka të përcaktuar sipërmarrës me FNT, operatorët nuk kanë detyrime specifike për të raportuar të dhënat e gjeneruara si dhe nuk ka tarifa të përcaktuara.
23. Vodafone Albania SHA për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, për shkak të dërrgullimit të plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nga AKEP, me efekt nga data 1.09.2012, është shprehur se përgjithësisht ka vepruar duke vendosur tarifa sipas trendit të tregut shqiptar apo atij rajonal si dhe e trajton në marrëveshje të veçanta tregtare mes operatorit ofrues të terminimit të thirrjeve dhe atij tranzitues.
24. Ndërmarrja Vodafone Albania SHA për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, për periudhën kohore nga 10 Prill 2015 deri në 31 Dhjetor 2021, ka lidhur kontrata për “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike”, dhe me ndërmarrje të tjera në treg të cilët ofrojnë të njëjtin shërbim si ndërmarrja Neofone SHPK.
25. Ndërmarrja Neofone SHPK ka lidhur një marrëveshje Interkoneksioni me Vodafone Albania SHA, “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike midis Vodafone Albania SHA dhe Neofone SHPK, datë 1.10.2012” dhe tarifa për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare ishte përcaktuar 6.1 lek/min.
26. Ndërmarrja Neofone SHPK ka pranuar dhe përdorur kapacitetin e ofruar nga Vodafone Albania SHA që prej datës 01.10.2012 deri në 10.04.2015, ku u ndërpre aksesit dhe interkoneksioni me Vodafone SHA, pasi Vodafone për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga operatori Neofone nga 6.1 lek/min e rriti në vlerën 29.8 lek/min.
27. Nga analiza e konkurrencës ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania në tregun me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtar, vihet re se: (i) Tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara ndaj operatorëve të cilët kishin një marrëveshje interkoneksioni me Vodafone ka qenë ka qenë XX lek/min deri në 30 qershor 2015, e cila ka vijuar të rritet në mënyrë graduale duke arritur në vlerën XX lek/min në 1 nëntor 2019. (ii) Gjithashtu operatorë të tjerë pas rritjes së tarifës së njoftuar nga Vodafone nuk kanë pranuar dhe nuk kanë ofruar më shërbimin e tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare por tarifata e rritura të njoftuara nga Vodafone kanë vijuar nga 2017 me XX lek/min deri në XX lek/min në vitin 2019.

28. Si përfundim, sa më sipër tarifa prej 29.8 lek/min e vendosur ndaj ndërmarrjes Neofone SHPK nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në vitin 2015 për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në kuptim të nenit 9, pika 2, shkronja (c) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të përbëj abuzim me pozitën dominuese duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 10 Prill 2015 deri në 24 Qershor 2022.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2022**
BULETINI ZYRTAR



2022